



**DOKUMENT  
PËR POLITIKA  
PËR TRANSPARENCËN,  
LLOGARIDHËNIEN  
DHE EFEKTIVITETIN  
E GJYQËSORIT ME FOKUS  
MBI PUNËN E GJKATAVE  
DHE ADMINISTRATËS  
GJYQËSORE**

---



DOKUMENT  
PËR POLITIKA  
PËR TRANSPARENCËN,  
LLOGARIDHËNIEN  
DHE EFEKTIVITETIN  
E GJYQËSORIT ME FOKUS  
MBI PUNËN E GJYKATAVE  
DHE ADMINISTRATËS  
GJYQËSORE

---

## IMPRESUM

### Titulli:

**DOKUMENT PËR POLITIKA PËR TRANSPARENCËN, LLOGARIDHËNIEN DHE EFEKTIVITETIN  
E GJYQËSORIT ME FOKUS MBI PUNËN E GJYKATAVE DHE ADMINISTRATËS GJYQËSORE**

### Botues:

**Instituti për të Drejtat e Njeriut (IDNj)  
Qendra për Kërkime dhe Analiza Juridike (QKAJ)**

### Rreth botuesit:

**Margarita Caca Nikollovska, IDNj  
Lidija Stojkova Zafirovska, QKAJ**

### Autorë:

**Velimir Delovski  
Sonja Gruvska  
Sandra Buzlieva**

### Redaktorë:

**Jelena Kadriq  
Maja Stojanoska  
Marko Guçeski**

### Lektura:

**Tatjana Stojanovska**

### Dizajni dhe shtypja:

**Arkus Design SHPK**

**Shkup, 2021**



Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit „Angazhimi i përbashkët për arritje më të mira në gjyqësor“ i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Sektorit për Financim Qendror dhe Lidhjen e Marrëveshjeve pranë Ministrisë së Financave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe bashkë-financuar nga Ambasada Britanike Shkup.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e partnerëve për zbatimin e projektit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Ambasadës Britanike në Shkup.

Publikimi është në dispozicion në [www.ihr.org.mk](http://www.ihr.org.mk) dhe në [www.cpia.mk](http://www.cpia.mk)

## PËRMBAJTJA

SHËNIME HYRËSE .....	6
1. KUADRI NDËRKOMBËTAR PËR TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE DHE EFEKTIVITET TË GJYQËSORIT, ME FOKUS NË PUNËN E GJYQTARËVE DHE ADMINISTRATËS GJYQËSORE .....	9
1.1 AKTORËT KRYESORË NË VENDOSJEN E STANDARDEVE PËR TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE DHE EFEKTIVITET TË GJYQËSORIT .....	11
1.2. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E GJYQËSORIT .....	14
1.3. EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI I GJYQËSORIT .....	18
1.4. STANDARDET E RËNDËSISHME PËR ADMINISTRATËN GJYQËSORE .....	26
2. POLITIKAT KOMBËTARE DHE KORNIZA JURIDIKE E TRANSPARENCËS, LLOGARIDHËNIES DHE EFEKTIVITETIT TË GJYQËSORIT, ME FOKUS NË PUNËN E ADMINISTRATËS GJYQËSORE .....	29
2.1. TRANSPARENCA NË PUNËN E GJYQTARËVE .....	31
2.2. PËRGJEGJËSIA NË PUNËN E GJYQTARËVE .....	35
2.3. EFEKTIVITETI NË PUNËN E GJYQTARËVE .....	40
3. POLITIKAT KOMBËTARE DHE KORNIZA JURIDIKE E TRANSPARENCËS, LLOGARIDHËNIES DHE EFEKTIVITETIT TË GJYQËSORIT, ME FOKUS NË PUNËN E ADMINISTRATËS GJYQËSORE .....	45
3.1. HYRJE .....	46
3.2. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË PUNËN E ADMINISTRATËS GJYQËSORE .....	56
SHËNIME PËRFUNDIMTARE .....	61
REKOMANDIME .....	64
LITERATURA E PËRDORUR .....	66

## SHËNIME HYRËSE

Transparenca, llogaridhënia dhe efektiviteti janë një nga parimet themelore në funksionimin e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për shkak të rëndësisë së tyre identifikohen prioritetet ndër strategjike në Strategjinë për Reformën në Sektorin e Jurisprudencës për periudhën 2017-2022<sup>1</sup>.

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2020<sup>2</sup>, thekson se "zbatimi i plotë i parimeve të pavarësisë dhe transparencës duhet të vazhdojë, veçanërisht për t'i dhënë fund të gjitha kritikave ndaj gjyqësorit që i nënshtrohen pushtetit ekzekutiv, duke përfshirë sigurimin që emërimet të bazohen plotësisht në merita dhe kompetencë".

1 Strategjia për reformën e sektorit gjyqësor për periudhën 2017-2022, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë, 2017. Në dispozicion në [https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategjia%20i%20akciski%20plan\\_MK-web.pdf](https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategjia%20i%20akciski%20plan_MK-web.pdf)

2 Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020, Komisioni Evropian, 2020. Në dispozicion në <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657#.YIGrRSORpbU>

Me respektimin e këtyre parimeve të transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit, arrihen qëllimet dhe funksionet e gjyqësorit: zbatimi i paanshëm i ligjit pavarësisht nga pozicioni dhe kapaciteti i palëve, mbrojtja, respektimi dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, sigurimi i barazisë, mosdiskriminimi mbi çfarëdo bazë dhe sigurimi i sigurisë juridike bazuar në shtetin e së drejtës. Secili ka të drejtë për qasje të barabartë para gjykatës në mbrojtje të të drejtave të tij dhe interesat mbi baza ligjore.<sup>3</sup>

Çështja kryesore që ky dokument përpiqet t'i japë përgjigje është se sa korniza juridike në Republikën e Maqedonisë së Veriut që rregullon parimet e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit në gjyqësor është në përputhje me standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe synon të propozojë rekomandime për përmirësimin e saj.

Në këtë drejtim, dokumenti për politika ndahet në tre pjesë, pjesa e parë do të paraqesë kornizën ndërkombëtare përkatëse në këto fusha, me standardet rajonale, evropiane të ndërtuara përmes mekanizmave të Këshillit të Evropës të një rëndësie parësore. Këto mekanizma luajnë rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e shtetit të së drejtës, si një nga tre shtyllat kryesore mbi të cilat mbështetet sistemi i Këshillit të Evropës, së bashku me demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Shumica e tyre para së gjithash i referohen punës së gjyqtarëve, por në një pjesë prekin edhe administratën gjyqësore.

<sup>3</sup> Ligji për Gjykatat, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019.

Gjithashtu do të merren parasysh edhe qëndrimet që janë marrë përmes jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në lidhje me efektivitetin, porë përmes prizmit të së drejtës për gjykim në afat racional si pjesë integrale e së drejtës për procedurë gjyqësore të drejtë të garantuar nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ, Konventa), si dhe transparenca e cila, nga ana tjetër, manifestohet përmes parimit të publicitetit të procedurave gjyqësore.

Pjesa e dytë e këtij dokumenti adreson politikat kombëtare dhe kornizën juridike në lidhje me parimet e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të gjyqësorit me një fokus të veçantë tek gjyqtarët. Kjo pjesë diskuton këto parime të punës së gjyqtarëve nga aspekti i rregullimit të tyre me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Ligjin për gjykata, Ligjin për Këshillin gjyqësor, Ligjin për procedurën penale, Ligjin për procedurën kontestimore, Ligjin për menaxhimin me lëvizjen e lëndëve gjyqësore, si dhe krahasim përmes raporteve dhe rekomandimeve nga institucionet vendase dhe organizata ndërkombëtare.

Pjesa e tretë e dokumentit për politika i kushtohet transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të administratës gjyqësore. Këto prioritete për sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit në gjyqësor janë të pamundura të arrihen plotësisht pa krijimin e një administrate gjyqësore transparente, llogaridhënëse dhe efektive, e cila nga ana tjetër është një faktor jashtëzakonisht i rëndësishëm për të siguruar funksionimin efikas të gjykatave. Fatkeqësisht, përkundër faktit se ekzistojnë dy dokumente kryesore strategjike në vend që ndikojnë drejtpërdrejt në administratën gjyqësore, asnjë prej tyre nuk përmban pothuajse asnjë masë dhe aktivitete që do të kishin ndikim mbi avancimin e gjendjes dhe statusit të administratës gjyqësore, si në përgjithësi ashtu edhe në aspektin e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit. Ky konstatim në nivel kombëtar reflektohet si në nivelin rajonal ashtu edhe në nivelin e Bashkimit Evropian.



1.

Kuadri Ndërkombëtar  
për Transparencë,  
Llogaridhënie  
dhe Efektivitet  
të Gjyqësorit, me  
fokus në punën  
e gjyqtarëve dhe  
administratës gjyqësore

---

Pjesa e parë e dokumentit të politikave për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet të gjyqësorit do të paraqesë kornizën përkatëse ndërkombëtare në këto fusha, gjatë çka me rëndësi primare janë standardet rajonale, evropiane të ndërtuara përmes mekanizmave të Këshillit të Evropës, siç janë:

- » Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (KKGjE) dhe
- » Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).

Këto mekanizma luajnë rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e shtetit të së drejtës, si një nga tre shtyllat kryesore mbi të cilat mbështetet sistemi i Këshillit të Evropës, së bashku me demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Shumica e tyre para së gjithash i referohen punës së gjyqtarëve, por në një pjesë prekin edhe administratën gjyqësore.

Gjithashtu do të merren parasysh edhe qëndrimet që janë marrë përmes jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në lidhje me efektivitetin, parë përmes prizmit të së drejtës për gjykim në afat racional si pjesë integrale e së drejtës për procedurë gjyqësore të drejtë të garantuar nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ, Konventa), si dhe transparenca e cila, nga ana tjetër, manifestohet përmes parimit të publicitetit të procedurave gjyqësore.

## 1.1 AKTORËT KRYESORË NË VENDOSJEN E STANDARDEVE PËR TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE DHE EFEKTIVITET TË GJYQËSORIT

Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (KKGjE), themeluar në vitin 2000, është trup ekspertësh i përbërë ekskluzivisht nga gjyqtarë nga të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Mandati i tij ka për qëllim krijimin e standardeve në lidhje me statusin e gjyqtarëve dhe cilësinë e sistemit gjyqësor., me qëllim sigurimin e respektit të ndërsjellë midis pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe krijimin e besimit të shtuar të qytetarëve evropianë në sistemin gjyqësor. Gjatë kësaj, si trup konsultativ që merret me pavarësinë, paanësinë dhe kompetencën e gjyqtarëve, KKGjE i jep një rol thelbësor fuqisë së gjyqtarëve në një shoqëri demokratike.

Mjeti më i rëndësishëm për realizimin e mandatit të KKGjE paraqesin mendimet e tij, të cilat përdoren në hartimin e legjislacionit kombëtar, si mjete për funksionimin dhe / ose administrimin e drejtësisë dhe për organizimin e punës së profesioneve juridike.<sup>4</sup> Ato mund të jenë të dobishme si për gjyqtarët ashtu edhe për anëtarët e shërbimit gjyqësor (administratës), duke pasur parasysh që përmbajnë shënime specifike mbi zbatimin e standardeve të përgjithshme në lidhje me pavarësinë e gjyqtarëve, trajnimin e tyre, etikën dhe cilësinë e drejtësisë, efikasitetin dhe transparencën e sistemin gjyqësor.<sup>5</sup>

Përveç opinioneve të tij, një nga dokumentet kryesore të KKGjE është **Karta e Madhe e Gjyqtarëve** (Magna Carta)<sup>6</sup> në të cilën parimet themelore që dalin nga opinionet të tashmë i ka miratuar. Ndër të tjerat, në të janë përcaktuar postulatet e caktuara, si për shembull:

- » se drejtësia do të jetë transparente dhe do të publikohen informacione për punën e sistemit gjyqësor;<sup>7</sup>
- » Gjyqtarët do të ndërmarrin hapa për të siguruar qasjen në zgjidhjen e shpejtë, efikase dhe të qasshme të kontesteve dhe do të kontribuojnë në promovimin e metodave alternative të zgjidhjes së kontesteve;<sup>8</sup>
- » Gjyqtarët do të marrin vendime mirë të menduara, të bëra publike brenda një kohe të arsyeshme, bazuar në një seancë dëgjimore të drejtë dhe publike. Gjyqtarët do të zbatojnë metodat e duhura të menaxhimit me lëndët;<sup>9</sup>
- » Zbatimi i urdhrave të gjykatës është një përbërës kryesor i së drejtës për gjykim të drejtë dhe gjithashtu garanci për efektivitetin e drejtësisë.<sup>10</sup>

4 Të gjitha opinionet janë në dispozicion në lidhjen/linkun e mëposhtëm: <https://www.coe.int/en/web/ccje/ccje-opinions-and-magna-carta>

5 Council of Europe, Working Party on Institutional Reforms (GT-REF.INST), Strasbourg, 9 April 2009, Survey of steering and ad hoc committees: Overview of the survey of six steering and ad hoc committees whose terms of reference expire in 2009 (GT-REF.INST(2009)1-final), qëndrime 25-26

6 Consultative Council of European Judges, Magna Carta of Judges (Fundamental Principles), Strasbourg, 17 November 2010, CCJE (2010)3 Final

7 Paragrafi 14

8 Paragrafi 15

9 Paragrafi 16.

10 Paragrafi 17.

Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), themeluar në vitin 2002, ka për detyrë kryesore të propozojë zgjidhje konkrete për përmirësimin e funksionimit të sistemeve gjyqësore të shteteve dhe promovimin e zbatimit efektiv të instrumenteve të Këshillit të Evropës që kanë të bëjnë me organizimin e gjyqësorit; duke siguruar që politikat publike në lidhje me gjykatat të marrin parasysh nevojat e përdoruesve të sistemit të drejtësisë dhe parandalimin e shkeljeve të nenit 6 të Konventës me çka kontribuohet edhe drejt uljes së numrin e madh të lëndëve dhe ngecjen në Gjykatën e Strasburgut.

CEPEJ përmbush detyrat e tij përmes zhvillimit të indikatorëve për matjen e efikasitetit të gjyqësorit, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave sasiore dhe cilësore dhe përgatitjen e raporteve përkatëse me të dhëna statistikore mbi trendet më të fundit në vende përkatëse.

Përveç kësaj, ai krahason gjithashtu sistemet gjyqësore, qëllimi i të cilave jo vetëm që përqendrohet në efikasitetin në kuptimin më të ngushtë të fjalës, por gjithashtu thekson cilësinë dhe efektivitetin e drejtësisë.

Gjithashtu, që nga viti 2004 çdo dy vjet CEPEJ kryen vlerësimin e rregullt të sistemeve gjyqësore të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës përmes një grupi të veçantë pune (CEPEJ-GT-EVAL) i cili është përgjegjës për menaxhimin e këtij procesi.<sup>11</sup>

Përveç kriterëve të vendosura në praktikën e GJEDNJ-së që shërbejnë si pikë referimi për vlerësimin e efikasitetit gjyqësor (për sa i përket kohëzgjatjes së procedurave), CEPEJ ka zhvilluar dy tregues për vlerësimin e performancës së efikasitetit gjyqësor. Treguesi i parë është shkalla e përbushjes (*Clearance Rate*), e cila mat se sa efektivisht gjykatat ballafaqohen me fluksin e lëndëve gjyqësore. Treguesi i dytë i njohur si koha për dispozicion (*Disposition Time*), nga ana tjetër, mat numrin e llogaritur të ditëve të nevojshme për të përfunduar lëndët aktuale. Analizimi i këtyre dy faktorëve së bashku jep një ide fillestare të përgjithshme të efikasitetit të gjykatave në një vend të veçantë, ndërsa studimi i evolucionit të tyre me kalimin e kohës lejon një kuptim më të mirë të përpjekjeve të gjyqësorit për të ruajtur dhe / ose përmirësuar efikasitetin.<sup>12</sup>

Për më tepër, grupi punues për Menaxhimin e Kohës Gjyqësore (CEPEJ-SATURN)<sup>13</sup> ka zhvilluar kriterë të veçanta, të cilat duhet tu mundësojnë autoritetëve gjyqësore përmes zbatimit të një liste të detajuar të kontrollit (check list) të pikave kohore që janë të rëndësishme për trajtimin e lëndëve në mënyrë të saktë të monitorojnë kohëzgjatjen e procedurave, me qëllim të konstatojnë nëse përdorimi i kohës ishte në përputhje me kërkesat e neneve 5 dhe 6 të KEDNJ-së. Kështu, për shembull, data e fillimit të hetimit,

11 Edicioni i fundit, i tetë i raportit kombëtar të CEPEJ u publikua më 22 tetor 2020 dhe i referohet të dhënave që nga viti 2018. Në dispozicion në <https://rm.coe.int/evaluation-report-part-1-english/16809fc058>

12 European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), European Judicial Systems: Efficiency and Quality of Justice CEPEJ STUDIES No. 26, 2018 Edition (2016 Data), crp. 238, <https://rm.coe.int/rapport-avec-couv-18-09-2018-en/16808def9c>

13 European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), Revised Saturn Guidelines for Judicial Time Management (3rd revision), as adopted at the 31th plenary meeting of the CEPEJ, Strasbourg, 3 and 4 December 2018.

arrestimi i të dyshuarit, lëshimi i aktakuzës, si dhe publikimi dhe lëshimi i vendimit të shkallës së parë duhet të shënohen dhe të merren parasysht.<sup>14</sup>

Në bazë të indikatorëve të mësipërm të CEPEJ si dhe mbi të dhënat e gjeneruara duke përdorur metodologjinë e CEPEJ bazohet edhe *EU Justice Scoreboard*, si një lloj përmbledhje krahasuese e situatës në fushën e drejtësisë në të 28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), e cila ofron të dhëna të krahasueshme për pavarësinë, cilësinë dhe efikasitetin e sistemeve të jurisprudencës në vendet anëtare të BE-së. Në fakt, ky raport paraqet një mjet jo-detyrues që duke ndjekur trendet në funksionimin e sistemeve gjyqësore kombëtare shfaqet si komponent kyç në përcaktimin e politikave dhe zbatimin e reformave të nevojshme në sferën e jurisprudencës.<sup>15</sup>

14 European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), Working Group on Judicial Time Management (CEPEJ-SATURN), Time Requirements arising from Articles 5 and 6 of the European Convention on Human Rights: Implementation Manual for Criminal Cases, Strasbourg, 15 May 2020, CEPEJ-SATURN(2019)3Rev, faq.3. Për më shumë informacion, shih <https://www.coe.int/en/web/cepej/cepej-work/saturn-centre-for-judicial-time-management>

15 European Union, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Central Bank, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, The EU Justice Scoreboard: A Tool to Promote Effective Justice and Growth, COM/2013/0160 final, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:52013DC0160>

## 1.2 TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E GJYQËSORIT

### 1.2.1. Transparenca në opinionet e KKGJË

Transparenca e gjyqësorit mund të shihet para së gjithash përmes prizmit të **Opinionit nr.7 (2005) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJË)** për “Drejtësi dhe Shoqëri”.<sup>16</sup> Ky Opinion ka të bëjë me marrëdhëniet e gjykatave me publikun, marrëdhëniet e gjykatave me personat e përfshirë në procedurat gjyqësore, si dhe marrëdhëniet me median.<sup>17</sup>

BNë lidhje me **marrëdhëniet e gjykatave me publikun**, Opinioni flet për rëndësinë e qytetarëve të dinë se si funksionojnë institucionet gjyqësore,<sup>18</sup> ndërsa gjykatat të pranohen nga publiku i gjerë si një forum i përshtatshëm për vendosjen e të drejtave dhe detyrimeve ligjore dhe zgjidhjen e kontesteve në lidhje me këtë. Në këtë drejtim, theksohet se informacioni i duhur për funksionet e gjyqësorit dhe rolin e tij mund të kontribuojë në mënyrë efektive në një kuptim të shtuar të gjykatave si gur themel i sistemeve kushtetuese demokratike, si dhe në kufizimet e aktivitetit të tyre.<sup>19</sup>

Hapja dhe transparenca e gjykatave përcaktohet përmes rolit thelbësor të mediave për të përcjellë informacionin tek publiku në lidhje me rolin dhe aktivitetet e gjykatave dhe krijimin e marrëdhënieve të drejtpërdrejta midis gjykatave dhe publikut të gjerë, ku ato duhet të kontribuojnë në transparencën e procesit gjyqësor.<sup>20</sup>

Nga ana e tyre, gjykatat mund të përdorin disa mënyra për të siguruar transparencë përmes të ashtuquajturit “Rol edukativ”, përfshirja e së cilës duhet të zgjerohet,<sup>21</sup> përfshirë edhe në drejtim të informimit të publikut për aktivitetet e gjykatave<sup>22</sup> duke organizuar vizita edukative,<sup>23</sup> hpërndarjen e informacionit në lidhje me qasjen në drejtësi<sup>24</sup> dhe zhvillimin e programeve të përshtatshme arsimore.<sup>25</sup>

Megjithëse konsiderohet se gjyqtarët shprehen përmes vendimeve të tyre dhe ata nuk duhet t'i shpjegojnë ato para shtypit ose të bëjnë deklarata publike në shtyp për lëndët për të cilat procedojnë, përsëri do të ishte e dobishme të përmirësohen marrëdhëniet dhe

16 Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No. 7 (2005) of the Consultative Council of European Judges (CCJE) “On Justice and Society”, adopted by the CCJE at its 6th meeting (Strasbourg, 23-25 November 2005), CCJE (2005) OP No. 7

17 Paragrafi 5

18 Paragrafi 6

19 Paragrafi 8

20 Paragrafi 9

21 Paragrafi 15

22 Paragrafi 10

23 Paragrafi 11

24 Paragrafi 13

25 Paragrafi 13 i Opinionin nr.7 (2005) dhe paragrafët 12-15 të Opinionit nr. 6 (2004)

kontaktet midis gjykatave dhe mediave në mënyrë që i) të forcohet kuptimi i roleve të tyre; ii) informimi i publikut për natyrën, përfshirjen, kufizimet dhe kompleksitetin e punës në gjykatë dhe iii) korrigjimin e gabimeve të mundshme faktike gjatë raportimit për lëndë të caktuara.<sup>26</sup> Në të njëjtën kohë, gjyqtarët duhet të kenë njëfarë roli mbikëqyrës mbi zëdhënësit e gjykatave ose stafin përgjegjës për komunikimin me media.<sup>27</sup>

Në Opinioni nr. 19 (2016) në Këshillin Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) mbi rolin e kryetarëve të gjykatave<sup>28</sup> theksohet se në marrëdhëniet e tyre me mediat, duhet të kenë parasysh se interesat e shoqërisë, ju imponojnë që ata të sigurojnë informacionin e nevojshëm për media në mënyrë që publiku të informohet për funksionimin e sistemit të drejtësisë,<sup>29</sup> megjithatë ata duhet të respektojnë pavarësinë e brendshme të gjykatësve brenda gjykatave të tyre.<sup>30</sup>

Megjithëse parimi i publicitetit nënkupton që qytetarëve dhe profesionistëve të medias duhet t'u lejohet hyrja në sallat e gjyqit ku mbahen seancat, kryetarit të trupit gjykues duhet t'i jepet mundësia të vendosë për kushtet e incizimit dhe ta ndërpresë atë në çdo kohë, nëse është masë e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e atyre që janë përfshirë,<sup>31</sup> me çka do të mbahet llogari për mënyrën e incizimit në mënyrë që të mos pengohet zhvillimi i duhur i gjykimit.<sup>32</sup>

## 1.2.2. Parimi i publicitetit në jurisprudencën e GJEDNJ

Parimi i publicitetit të procedurave gjyqësore sipas nenit 6 të KEDNJ-së, në vete përfshin disa elementë, nga të cilët elementi i transparencës pasqyrohet veçanërisht në hapjen e seancave gjyqësore për media dhe publikun e gjerë (Riepan v. Austria), si dhe në bërjen publike të vendimeve gjyqësore (Pretto and Others v. Italy, §§20-28).

Qëllimi i rregullit të bërjes së procedurës publike është të mbrojë palët kontestimore, përkatësisht të pandehurit në procedurat penale nga zbatimi i fshehtë i drejtësisë dhe të sigurojë dukshmëri më të madhe të drejtësisë, me çka do të forcohet besimi shoqëror në jurisprudencë (Axen kundër Gjermanisë). Publiciteti mundëson mediat të kryejnë funksionin e tyre të "qenit- rojtar", që gjithashtu garantohet nga neni 10 i Konventës.

Sidoqoftë, neni 6 është lex specialis lidhur me kufizimet në praninë e mediave në seancat gjyqësore. Duke qenë se bëhet fjalë për të drejtë të kualifikuar, e cila parashikon përjashtime të caktuara nga parimi i publicitetit, kur paragrafi 2 i këtij neni thotë se "gazetarët dhe publiku mund të përjashtohen nga e gjithë ose një pjesë e procedurave

26 Paragrafi 34 i Opinioni nr.7 (2005)

27 Paragrafi 35 dhe pjesa C.2 nga Opinioni nr.7 (2005)

28 Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No.19 (2016) of the Consultative Council of European Judges (CCJE) on the Role of Court Presidents, Strasbourg, 10 November 2016, CCJE(2016)2

29 Paragrafi 12

30 Paragrafi 13

31 Paragrafi 47

32 Paragrafi 50

gjyqësore në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur këtë e imponojnë interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në kontest, ose kur sipas mendimit të gjykatës është rreptësisht e nevojshme në rrethana të veçanta sepse publiku (publiciteti) mund tu shkaktojë dëm interesave të drejtësisë”.

Mirëpo, ekziston gjithmonë supozim në favor të gjykimit publik, ndërsa përjashtimet nga ai duhet të jenë vërtet të nevojshme në rrethanat e lëndës, e cila, nga ana tjetër, përcaktohet nga zbatimi i të ashtuquajturit test proporcional (Campbell and Fell v. the United Kingdom, §§86-92).

Si rregull, asnjë proces gjyqësor nuk duhet të mbahet “pas dyerve të mbyllura” (in camera) Për më tepër, gjyqtari duhet të individualizojë vendimin e tij për të përjashtuar publikun ndërsa lëshimi për të mbajtur një seancë dëgjimore publike në shkallën e parë nuk do të rregullohet nëse ankesa shqyrtohet para publikut, përveç nëse gjykata e apelit ka juridiksion të plotë për rishqyrtimin e saj (Diennet v. Franca)

Disa nga procedurat ku parimi i publicitetit nuk është respektuar, që cili rezultoi në konstatimin e shkeljes së nenit 6 paragrafi 1, përfshijnë:

- » përjashtimin e publikut sipas automatizmit në procedurë në lidhje me konfiskimin e pasurisë së personit të akuzuar nga strukturat mafioze, ku procedura u mbyll në përputhje me kërkesat ligjore (Bocellari dhe Rizza kundër Italisë);
- » mbyllja e gjyqit për një të burgosur tashmë të dënua për publikun pa informuar autoritetet publikun për datën dhe vendin e gjykimit në burg (Riepan kundër Austrisë);
- » kur publikut iu kërkua të merrte miratimin e autoriteteve të burgut, si dhe t'i nënshtrohej një kontrolli fizik për të marrë pjesë në gjykimin në burg (Hummatov kundër Azerbajxhanit), etj.

Të rralla janë rastet kur përjashtimi i publikut nga gjykimi arsyetohet vetëm për arsye sigurie (Riepan kundër Austrisë, § 34) dhe kur është vërtet e nevojshme. Gjyqtarët duhet të marrin në konsideratë të gjitha alternativat e mundshme për të siguruar sigurinë në sallën e gjyqit dhe t'u japin përparësi masave më pak të rrepta përkundër atyre më të rreptave nëse me to mund të arrihet u njëjti qëllim (Krestovskiy kundër Rusisë, § 29).

Çështja e publicitetit në procedurat gjyqësore u ngrit gjithashtu edhe në lëndën Boshkoski. Në të, publiku u përjashtua nga tre seanca dëgjimore me arsyetimin se do të paraqiteshin prova të siguruar me zbatimin eve masa të posaçme hetimore,<sup>33</sup> përkatësisht se do të dëgjohet një dëshmitar i rrezikuar.<sup>34</sup> EGJEDNJ përsëriti (§50) se para se të përjashtojnë publikun nga procedura penale, gjykatat duhet të përcaktojnë në mënyrë specifike se përjashtimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesin e fortë publik dhe të kufizojnë fshehtësinë në masën e nevojshme për të mbrojtur një interes të tillë (§52). Megjithëse GJEDNJ pranoi që ndonjë prej arsyeve mbi të cilat mbështeteshin gjykatat vendase në

33 Paragrafi 14

34 Paragrafi 15



parim mund të justifikonte përjashtimin e publikut, në rastin aktual gjykata gjykuese nuk ndërmori ndonjë masë për të kundërpeshuar efektin e dëmshëm që vendimi për të mbajtur seancë të mbyllur për publikun, më siguri e kanë marrë në bazë të besimit të publikut në zbatimin e duhur të drejtësisë. Së këndejmi, në rrethanat e lëndës nuk ishte i justifikuar objektivisht përjashtimi i publikut nga seancat gjyqësore.<sup>35</sup>

Lidhur me natyrën publike të vendimeve gjyqësore, në bazë të qëndrimeve të GJEDNJ-së, nuk ekziston asnjë detyrim që teksti i plotë i aktvendimit gjyqësor të lexohet në seancë dëgjimore publike, pasi publikimi i tij në formë të shkruar konsiderohet i mjaftueshëm (Pretto and Others v. Italy). Për më tepër, vendimi duhet të jetë i disponueshëm për konsultim në shërbimet gjyqësore (regjistrin) (Pretto and Others v. Italy). Në këtë drejtim, GJEDNJ konstatoi shkelje të garancive të nenit 6 të KEDNJ-së, për publicitetin e procedurave gjyqësore në rastet kur aktgjykimi nuk ishte i disponueshëm në shërbimet ose në ueb faqen e gjykatës, dhe as personi i akuzuari nuk u lejua të mernte kopje për një periudhë të gjatë kohore, si rezultat i faktit se e gjithë dosja e lëndës ishte klasifikuar si sekrete, dhe përveç kësaj, nuk është bërë analizë përkatëse e proporcionalitetit të masës nga gjykatat kompetente vendase që proceduan lëndën (Nikolova and Vandova v. Bulgaria, §§75-85).

Si rregull, mënyra e publikimit të aktgjykimit në përputhje me ligjin kombëtar të shtetit të paditur duhet të vlerësohet duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të procedurave në fjalë dhe duke iu referuar qëllimit të nenit 6 paragrafi 1 në këtë kontekst, përkatësisht për të siguruar mbikëqyrjen publike të gjyqësorit në mënyrë që të mbrojë të drejtën për proces gjyqësor të drejtë. Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, e gjithë procedura duhet të merret parasysh (Welke and Białek v. Poland, § 83, ku kufizimi i ekspozimit publik të gjykimeve në procedurë që është mbajtur sekrete nuk ishte në kundërshtim me nenin 6).

Fshehja e plotë nga publiku e përmbajtjes së vendimit gjyqësor nuk mund të justifikohet, duke pasur parasysh se interesat e ligjshëm për mbrojtjen e sigurisë mund të mbrohen përmes teknikave të caktuara, siç janë klasifikimi i vetëm atyre pjesëve të vendimeve gjyqësore, zbulimi i të cilave do të rrezikonte sigurinë e shtetit ose sigurinë e të tjerëve (Raza v. Bulgaria, § 53; Fazliyski v. Bulgaria, §§ 67-68).

35 Paragrafi 53

## 1.3 EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI I GJYQËSORIT

### 1.3.1 Instrumentet përkatëse të Këshillit të Evropës

Qysh në pjesën hyrëse të Rekomandimit CM / Rec (2010) 12 mbi gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësia<sup>36</sup> Këshilli i Evropës thekson nevojën për të garantuar statusin dhe kompetencat e gjyqtarëve me qëllim arrijtjen e një sistemi ligjor efikas dhe të barabartë, në të cilin ata do të angazhohen në mënyrë aktive për funksionimin e sistemit gjyqësor.<sup>37</sup>

Ky Rekomandim përcakton efikasitetin e gjyqtarëve dhe sistemeve gjyqësore si një parakusht i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të çdo personi, harmonizimin me kërkesat e nenit 6 të Konventës, sigurinë juridike dhe besimin e publikut në shtetin e së drejtës.<sup>38</sup>

Efikasiteti përcaktohet si realizimin e vendimeve cilësore në kuadër të kohës së arsyeshme pas shqyrtimit të drejtë të lëndëve. Në këtë kuptim, gjyqtarët individualë janë të detyruar të sigurojnë menaxhimin efektiv të lëndëve për të cilat ata janë përgjegjës, përfshirë ekzekutimin e vendimeve.<sup>39</sup>

Pavarësia nuk duhet të jetë pengesë për efikasitetin e gjyqësorit, por ato janë komplementare, megjithatë është e nevojshme të balancohen në mënyrë që kërkimi drejt efikasitetit të përforcohet të mos kompromentojë pavarësinë. Për dallim nga pavarësia që mbron gjyqtarin si bartës i autorizimeve publike, efikasiteti i referohet rolit të tij në sistemin gjyqësor, i cili kërkon, ndër të tjera, shpejtësi, ekonomi dhe efikasitet në mbrojtjen e të drejtave dhe në përcaktimin e detyrimeve.<sup>40</sup>

Përveç kësaj, efikasiteti i referohet aspekteve cilësore dhe sasiore, përveç gjyqtarëve individualë të cilët në punën e tyre duhet të jenë të vetëdijshëm për kontributin e tyre drejt efikasitetit dhe duhet, për shembull, të përdorin të gjitha mjetet procedurale për menaxhimin e lëndëve të parashikuara nga ligji si dhe të demonstrojnë organizim personal,<sup>41</sup> gjithashtu tançon edhe autoritetet përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor, të cilët janë të detyruar t'u sigurojnë gjyqtarëve kushte që do t'u mundësojnë përmbushjen e misionit dhe të arrijnë efikasitetin, duke mbrojtur dhe respektuar pavarësinë dhe paanësinë.<sup>42</sup>

36 Recommendation CM/Rec(2010)12, adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on 17 November 2010, CM/ Rec(2010)12

37 Ky rekomandim është rishikuar në mënyrë thelbësore dhe është zëvendësuar në tërësinë e tij Rekomandim Nr. R (94) 12 of the Committee of Ministers to Member States on the Independence, Efficiency and Role of Judges (Adopted by the Committee of Ministers on 13 October 1994 at the 518th meeting of the Ministers' Deputies)

38 Paragrafi 30

39 Paragrafi 31

40 Paragrafi 37 i Memorandimit Shpjegues ndaj Rekomandimit

41 Paragrafi 40 i Memorandimit Shpjegues të Rekomandimit

42 Paragrafi 32

Ky Rekomandim thotë që çdo shtet duhet t'u sigurojë gjyqtarëve burime, pajisje dhe kushte të përshtatshme për t'i lejuar të veprojnë në përputhje me standardet e përcaktuara në nenin 6 të Konventës dhe të veprojnë në mënyrë efektive.<sup>43</sup> Në të njëjtën kohë, atyre duhet t'u sigurohet informacioni i nevojshëm për t'i mundësuar që të marrin vendime procedurale përkatëse kur ato vendime kanë implikime financiare,<sup>44</sup> si kur bëhet fjalë për veprime të tilla si marrja në pyetje e dëshmitarit, ndihma juridike, etj., gjatë çka ata duhet të kenë të drejtë për kushte adekuate të punës të cilat nuk duhet të kufizojnë zgjedhjen e tyre për një linjë të veçantë veprimi ose vendimi.<sup>45</sup>

Theksi vihet gjithashtu në nevojën që gjykatat të vendosin staf ndihmës të kualifikuar në mënyrë adekuate, përveç një numri të mjaftueshëm të gjyqtarëve,<sup>46</sup> të zgjedhur në bazë të kriterëve objektive, si parakusht që gjyqtarët të punojnë në mënyrë më efektive dhe të marrin vendimet e tyre shpejt,<sup>47</sup> dërsa me qëllim të parandalohet dhe zvogëlohet ngarkesa e tepërt e punës,<sup>48</sup> si dhe të zvogëlohet barra e gjyqtarëve dhe t'u mundësohet të përqendrohen në trajtimin dhe vendimmarrjen për lëndë, ndërsa personave të tjerë të kualifikuar tu besojnë detyrat jo gjyqësore.<sup>49</sup>

Në kontekstin e efikasitetit, në Rekomandimin CM / Rec (2010) 12<sup>50</sup> përcaktohet obligim për menaxhim efikas me lëndë me kujdesin e duhur dhe në kuadër të kohës së arsyeshme, që nuk vlen vetëm për gjyqtarët individualë, por edhe për kryetarët e gjykatave dhe autoritetet e tjera kompetente që kanë rol kryesor, veçanërisht në përmbushjen e kërkesës për "kohë të arsyeshme" të nenit 6 të Konventës dhe uniformitetin e dëshiruar në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, gjatë çka duhet të respektojnë plotësisht pavarësinë e secilit gjyqtar individual. Si shembull, kryetarët e gjykatave mund të organizojnë takime për të shkëmbyer mendime midis gjyqtarëve për një çështje të veçantë juridike dhe të ndajnë "praktika të mira" me njëri-tjetrin, si dhe të vendosin prioritete dhe objektiva që duhet të arrihen gjatë menaxhimit të lëndëve, duke pasur parasysh nevojën të ndalohet, zvogëlohet dhe eliminohet vonesa. Nga ana tjetër, vetë gjyqtarët duhet të marrin një qëndrim aktiv kundër taktikave të prolongimit, por gjithashtu të ulin shpenzimet për palët në një masë të arsyeshme përmes menaxhimit të shpejtë dhe transparent të lëndëve.<sup>51</sup>

Në të njëjtën kohë, rekomandohet që përdorimi i sistemeve elektronike të menaxhimit me lëndët të promovohet nga autoritetet dhe gjykatësit.<sup>52</sup> CEPEJ i percepton këto sisteme

43 Paragrafi 33

44 Paragrafi 34

45 Paragrafi 41 i Memorandumit Shpjegues të Rekomandimit

46 Paragrafi 35

47 Paragrafi 42 i Memorandumit Shpjegues të Rekomandimit

48 Paragrafi 36

49 Paragrafi 43 i Memorandumit Shpjegues të Rekomandimit

50 Recommendation CM/Rec(2010)12, adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on 17 November 2010

51 Paragrafi 62 i Memorandumit Shpjegues të Rekomandimit Përndryshe, në Opinionin nr. 19 (2016) për rolin e kryetarëve të gjykatave shprehet se roli i tyre është të përfaqësojnë gjykatën dhe kolegët gjykatës, për të siguruar funksionimin efektiv të gjykatës, gjë që do të përmirësojë shërbimin gjyqësor në shoqëri (paragrafi 6).

52 Paragrafi 37 i Protokollit dhe paragrafi 44 i Memorandumit Shpjegues të Rekomandimit.

si forca kryesore lëvizëse për veprimtarinë e gjykatave, dhe çdo online sistem i destinuar për palët ose avokatët duhet të mbështetet në një infrastrukturë të tillë për shkëmbimin automatik të të dhënave.<sup>53</sup>

Dhe në Rekomandimin nr. R (86) 12 i Komitetit të Ministrave<sup>54</sup> flitet për masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ngarkesës së gjykatave, përmes ndërmjetësimit dhe procedurave të tjera jashtë gjyqësore për zgjidhjen e kontesteve, rolin e gjyqtarit në promovimin e marrëveshjes miqësore, shkarkimin e tij nga detyrat jo-gjyqësore, gjykimin në shkallën e parë nga një gjyqtar, në vend të gjykimit në këshilla, sigurimin e ekuilibruar në shpërndarjen e ngarkesës së punës së gjykatave, në varësi të kompetencës së tyre, etj.

Relevant është edhe **Opinionin nr.2 (2001) mbi financimin dhe administrimin e gjykatave me qëllim efikasitetin e gjyqësorit dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**,<sup>55</sup> e cila i referohet lidhjes evidente midis financimit dhe menaxhimit me gjykatat, nga njëra anë, dhe parimeve të KEDNJ-së, nga ana tjetër, duke pasur parasysh se qasja në drejtësi dhe e drejta për gjykim të drejtë nuk janë të garantuara në mënyrë adekuate nëse lënda nuk mund të procedohet në afat të arsyeshëm nga gjykata që ka në dispozicion fondet dhe burimet përkatëse për të funksionuar në mënyrë efikase.<sup>56</sup>

Në **Opinionin (2012) nr. 15 të Këshillit Këshillimor të Gjyqtarëve Evropianë mbi specializimin e gjyqtarëve** ndër avantazhet e mundshme të specializimit të gjyqtarëve është se mund të ndihmojë në efikasitetin e gjykatës dhe menaxhimin e lëndëve përmes ekspertizës më të madhe në një fushë të caktuar juridike.<sup>57</sup>

Në përgjithësi, KKGjE beson se "cilësia" e drejtësisë nuk duhet të kuptohet vetëm si një sinonim për "produktivitetin" e sistemit gjyqësor, por përmes një qasjeje cilësore duhet të përcaktohet aftësia e sistemit për t'iu përgjigjur kërkesës për drejtësi në përputhje me objektivat e përgjithshme të sistemit juridik, ku shpejtësia e procedurës përfaqëson vetëm një element, i cili shprehet gjithashtu në **Opinionin nr.6 (2004)**.<sup>58</sup> Në të theksohet se përdoruesit e shërbimeve gjyqësore jo vetëm që duhet të kenë qasje në gjykatat, por gjithashtu ata duhet të përfitojnë nga efektiviteti i shtuar i procedurave të aplikuara dhe të besueshme garanci se vendimet e marra do të zbatohen,<sup>59</sup> që nënkupton thjeshtimin dhe uljen e shpenzimeve të procedurave, përdorimin e teknologjive të reja, zvogëlimin

53 European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), European Judicial Systems: Efficiency and Quality of Justice CEPEJ STUDIES No. 26, 2018 Edition (2016 Data), faq. 216, seksioni 4.2.3, <https://rm.coe.int/rapport-avec-couv-18-09-2018-en/16808def9c>

54 Recommendation No. R (86) 12 of the Committee of Ministers to Member States concerning Measures to Prevent and Reduce the Excessive Workload in the Courts (Adopted by the Committee of Ministers on 16 September 1986 at the 399th meeting of the Ministers' Deputies)

55 Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No 2 (2001) of the Consultative Council of European States (CCJE) for the Attention of the Committee of Ministers of the Council of Europe on the Funding and Management of Courts with Reference to the Efficiency of the Judiciary and to Article 6 of the European Convention on Human Rights, Strasbourg, 23 November 2001, CCJE (2001) OP N°2

56 Paragrafi 3

57 Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No. 6 on "Fair trial within a Reasonable Time and Judge's Role in Trials" taking into account Alternative Means of Dispute Settlement, as adopted by the CCJE at its 5th meeting (Strasbourg, 22-24 November 2004), CCJE (2004) OP No. 6

58 Pjesa B.7. dhe paragrafi 42

59 Paragrafi 1

e ngarkesës së gjykatave dhe mënyrat alternative të zgjidhjes së kontesteve,<sup>60</sup> kështu që gjatë ballafaqimit me institucione gjyqësore është thelbësore që qytetarët të jenë të vetëdijshëm se kanë punë me një institucion efikas.<sup>61</sup>

KKGJE thekson rolin e gjyqtarëve në zbatimin e parimeve të përcaktuara në KEDNJ dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut,<sup>62</sup> dhe në veçanti përmes pjesëmarrjes së tyre në përpjekjet për të garantuar qasjen drejt zgjidhjes së shpejtë dhe efikase të mosmarrëveshjeve<sup>63</sup>, ashtu që do të menaxhohen në mënyrë aktive lëndët që nga fillimi dhe gjatë gjithë procedurës do të kontrollojë kornizën kohore dhe kohëzgjatjen e procedurës, ku ata do të vendosin afate të rrepta dhe do të autorizohen të refuzojnë prolongimet në procedurë, madje edhe kundër vullnetit të palëve.<sup>64</sup>

Në Opinionin nr.11 (2008) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE) mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore<sup>65</sup>, theksohet se gjyqtari duhet të jetë në gjendje të organizojë dhe zhvillojë në mënyrë aktive dhe të saktë procedurat, sepse pikërisht rrjedha e drejtë e procedurës rezulton me vendime cilësore si produkti i tyre përfundimtar.<sup>66</sup> Megjithatë miratimi i vendimit në afat kohor të arsyeshëm në pajtim me nenin 6 të KEDNJ-së, mund të konsiderohet vetëm si një element i rëndësishëm i cilësisë së vendimmarrjes, megjithatë KKGJE është i mendimit se duke pasur parasysh tensionin që mund të lindë midis shpejtësisë së zhvillimit të procedurës dhe faktorëve të tjerë që mund të jenë të rëndësishëm për cilësinë<sup>67</sup>, duhet të arrihet vendosja e modeleve standarde të praktikave të mira në menaxhimin me lëndë dhe udhëheqjen e procedurave tek secili gjyqtar.<sup>68</sup>

Efikasiteti përmendet gjithashtu si një nga kriteret objektive në sistemin e meritës për vlerësimin e gjyqtarëve sipas Opinionin nr.17 (2014), përveç kualifikimeve, integritetit dhe aftësive të tyre.<sup>69</sup>

Më në fund, CEPEJ përcakton perceptimin e efikasitetit si një nga tre faktorët kryesorë që përcaktojnë besimin në gjyqësor, përveç drejtësisë shpërndarëse dhe procedurale. Gjegjësisht, nëse njerëzit besojnë se procedurat gjyqësore janë të organizuara në një mënyrë efikase, se ato zhvillohen pa vonesa të paarsyeshme dhe se aktgjykimet kryhen në mënyrë efektive, kjo do të rezultojë me pranim përgjithësisht më të madh të vendimeve gjyqësore.<sup>70</sup>

60 Paragrafi 5

61 Paragrafi 8 и 9

62 Paragrafi 10

63 Paragrafi 7

64 Seksioni C.13 dhe paragrafët 90-102

65 Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No. 11 (2008) of the Consultative Council of European Judges (CCJE) to the attention of the Committee of Ministers of the Council of Europe on the quality of judicial decisions, Strasbourg, 18 December 2008, CCJE(2008)5

66 Paragrafi 25

67 Paragrafi 26

68 Paragrafi 27

69 Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No. 17 (2014) on the Evaluation of Judges' Work, the Quality of Justice and Respect for Judicial Independence, Strasbourg, 24 October 2014, CCJE(2014)2, paragrafi 31

70 European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), European Judicial Systems: Efficiency and Quality of Justice CEPEJ STUDIES No. 26, 2018 Edition (2016 Data), faq. 222, pjesa 4.3, <https://rm.coe.int/rapport-avec-couv-18-09-2018-en/16808def9c>

### 1.3.2. Efektiviteti i procedurave gjyqësore në drejtim të së drejtës për gjykim në afat kohor të arsyeshëm

Këshilli i Evropës dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i kushtojnë vëmendje të veçantë kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave gjyqësore (H. v. France). Në fakt, e drejta për gjykim në afat kohor të arsyeshëm rrjedh nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili thotë:

*"NË PËRCAKTIMIN E TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TË TIJ CIVILE OSE ÇDO AKUZË PENALE KUNDËR TIJ, TË GIJTHË KANË TË DREJTË PËR GJYKIM TË DREJTË DHE PUBLIK ME AFAT KOHOR TË ARSYESHËM NGA NJË GJYKATË E PAVARUR DHE E PAANSHME E KRIJUAR ME LIGJ."*

Gjykata e Strasburgut thekson në veçanti se është e rëndësishme që drejtësia të zbatohet pa vonesë e cila mund të rrezikojë efektivitetin dhe besueshmërinë e saj (Scordino v. Italy (no. 1) [GC], § 224, H. v. France, § 58; Katte Klitsche de la Grange v. Italy, § 61). Ai sugjeron në nevojën për ndryshime sistematike në sistemet ligjore individuale që synojnë braktisjen e praktikës së papërshtatshme gjyqësore, e cila do të sigurojë efektivitetin e procedurave gjyqësore, në mënyrë që të parandalojë shkelje të ngjashme të së drejtës për gjykim në afat kohor të arsyeshëm dhe në raste të ardhme të tjera, që do të ngriheshin para tij. Kjo, në fakt, mendohet kur thuhet se "nëse Gjykata konstaton se në një shtet të caktuar ekziston praktikë e cila nuk është në përputhje me Konventën si rezultat i akumulimit të shkeljeve të kërkesës për "kohë të arsyeshme", ajo do të përbënte një "rrethanë rënduese të nenit 6 paragrafi 1" (Bottazzi v. Italy [GC], § 22; Scordino v. Italy (no. 1) [GC], § 225).

GJEDNJ ka kuptimin e vet autonom për këtë problematikë, e cila ndryshon nga mënyra në të cilën gjatësia e veprimeve procedurale trajtohet në korniza nacionale. Në atë kuptim, për dallim nga sistemet kombëtare, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk ka një afat kohor fiks për kohëzgjatjen e një lloji të caktuar të procedurës, por të gjitha situatat shqyrtohen individualisht. Megjithatë, GJEDNJ përcakton standarde të qarta në lidhje me mënyrën e llogaritjes së të ashtuquajturës periudhë relevante ligjore e cila duhet të konsiderohet, ashtu edhe për sa i përket kriterëve për vlerësimin e kohës racionale.

Gjatë kësaj ekzistojnë disa ndryshime kur bëhet fjalë për procedurat civile dhe penale. Për shembull, në procedurat penale, periudha ligjore relevante fillon nga dita në të cilën një person është akuzuar për vepër të caktuar penale (Neumeister v. Austria, §18),<sup>71</sup> onga momenti i arrestimit (Wemhoff kundër Gjermanisë, § 19), nga fillimi i procedurave paragjyqësore (Ringeisen k. Austrisë, § 110; Šubinski v. Sllovenisë, §§ 65-68), ose marrja në pyetje e një personi të dyshuar për kryerjen e veprës penale (Kalēja v. Latvia, § 40), përkatësisht në çdo rast nga momenti kur personi është i vetëdijshëm për akuzën ose kur ishte prekur në të vërtetë nga masat e marra në kontekstin e hetimit penal ose

71 Council of Europe, Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights: Right to a Fair Trial (criminal limb), Updated on 31 August 2020, [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_criminal\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_criminal_ENG.pdf), paragrafi 297

procedurës (Mamič v. Sllovenisë (nr. 2), §§ 23-24).<sup>72</sup> Nga ana tjetër, në procedurat civile, si pikënisje zakonisht merret momenti kur është ngritur një proces gjyqësor para gjykatës kompetente (Poiss v. Austria, § 50; Bock v. Germany, § 35), përveç nëse paraqitja e kërkesës në organ administrativ është parakusht për fillimin e procedurës gjyqësore, kur periudha duhet të përfshijë procedurën e detyrueshme paraprake administrative (König v. Germany, § 98; X v. France, § 31; Kress v. France [GC], § 90).<sup>73</sup>

Standardi për gjykim në afat kohor të arsyeshëm është i zbatueshëm për të gjithë procedurën dhe mbulon të gjitha instancat gjyqësore, derinë miratimin e vendimit gjyqësor të plotfuqishëm përfundimtar, si dhe të gjitha fazat e procedimit penal në fjalë (König v. Germany, § 98), përfshirë procedurën e apelimit (Delcourt v. Belgium, §§ 25-26; König v. Germany, § 98; V. v. the United Kingdom [GC], § 109).<sup>74</sup> Kjo gjithashtu nënkupton detyrim për ekzekutimin e shpejtë të vendimeve gjyqësore penale përfundimtare, duke filluar nga premisa që ekzekutimi i vendimeve gjyqësore konsiderohet si pjesë integrale e procedurave gjyqësore (Assanidze v. Georgia [GC], § 181, Martins Moreira v. Portugal, § 44; Silva Pontes v. Portugal, § 33).

Analizën e arsyes së kohëzgjatjes së procedurës Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e bën duke pasur parasysh rrethanat e lëndës, gjë që kërkon vlerësim gjithëpërfshirës (Boddaert v. Belgium, § 36).

GJEDNJ ka parasysh katër kriteret kryesore që përdor për të përcaktuar nëse zgjatja e procedurave ishte e arsyeshme, përkatësisht: kompleksiteti i lëndës; sjellja e aplikantit; sjellja e autoriteteve kompetente dhe interesi i aplikantit në fjalë (Frydlender v. France [GC], § 43; Sürmeli v. Germany [GC], § 128; Lupeni Greek Catholic Parish and Others v. Romania [GC], § 143; Nicolae Virgiliu Tănase v. Romania [GC], § 209).

Në lidhje me sjelljen e autoriteteve përkatëse, GJEDNJ detyron shtetet të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë të tillë që ata të mund të plotësojnë kërkesat e ndryshme që dalin nga ky nen (Abdoella v. the Netherlands, § 24; Dobbertain v. France, § 44), domethënë, në mënyrë që gjykatat t'i garantojnë secilit të drejtën për vendim përfundimtar në kontestet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile në kuadër të një periudhe kohore të arsyeshme (Comingersoll S.A. v. Portugal [GC], § 24; Lupeni Greek Catholic Parish and Others v. Romania [GC], § 142). Gjithashtu është e rëndësishme nga pikëpamja e efikasitetit të procedurave gjyqësore vendase se duhet pasur kujdes për të shmangur vonesat e pajustificuara ose vonesat e tepërta nga gjykatat e shkallës së parë (Wemhoff v. Germany, § 18).

72 Ibid, paragrafi 298

73 Council of Europe, Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights: Right to a Fair Trial (civil limb), Updated on 31 August 2020, [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_ENG.pdf), paragrafi 416

74 Council of Europe, Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights: Right to a Fair Trial (criminal limb), Updated on 31 August 2020, [https://echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_criminal\\_ENG.pdf](https://echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_criminal_ENG.pdf), paragrafi 300

Në parim, ngecja e përkohshme e lëndëve gjyqësore nuk përfshin përgjegjësinë e shteteve nëse marrin masa të caktuara urgjente për të kapërcyer situatën e tillë në mënyrë që të merren me situata emergjente të këtij lloji (Milasi v. Italy, § 18; Baggetta v. Italy, § 23),<sup>75</sup> veçanërisht kur bëhet fjalë për zgjatjen e procedurës që rezulton nga një problem në organizatën strukturore (Zimmermann and Steiner v. Switzerland, § 29; Guincho v. Portugal, § 40). Fakti që situatat e lëndëve të ngecura janë bërë praktikë e zakonshme në asnjë mënyrë nuk justifikon zgjatjen e tepruar të procedurave vendore (Unión Alimentaria Sanders S.A. v. Spain, § 40).<sup>76</sup>

GJEDNJ gjithashtu thekson se detyra e shtetit është të sigurojë që zbatimi i drejtësisë organizuar në mënyrë përkatëse, në mënyrë që të shmangen ndryshimet e vazhdueshme të gjyqtarit i cili ngadalëson procedurat, duke pasur parasysh se secili gjyqtar i ri ka nevojë për kohë për t'u njohur me lëndën, e cila është arsyeja pse në raste të tilla konstatohet shkelje (Lechner dhe Hess k. Austrisë, § 58).<sup>77</sup> Gjykata gjithashtu ka marrë vendim se miratimi i vendimeve gjyqësore me të cilat anulohen vendimet gjyqësore paraprake të gjykatave më të ulëta dhe kthimin e lëndës për shqyrtim dhe vendimmarrje janë zakonisht për shkak të gabimeve të bëra nga gjykatat më të ulëta dhe se përsëritja e atyre procedurave mund të tregojë mangësi në sistemin gjyqësor. (Lupeni Greek Catholic Parish and Others v. Romania [GC], § 147).<sup>78</sup>

Koncepti i gjykimit në afat kohor të arsyeshëm si një aspekt i rëndësishëm i efikasitetit të gjyqësorit pasqyrohet në sistemin juridik maqedonas ose më konkretisht në nenin 6 paragrafi 1 i Ligjit për gjykatat i cili përcakton se "gjatë vendosjen për të drejtat dhe detyrimet civile dhe vendosjen për përgjegjësi penale, të gjithë kanë të drejtë për ... gjykim në afat kohor të arsyeshëm ...", si dhe në nenin 10 paragrafi 1 i të njëjtit ligj i cili thotë se një nga parimet mbi të cilën mbështetet procedura para gjykatës është parimi i gjykimit brenda një kohe të arsyeshme. Vetë kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim për afat kohor të arsyeshëm si mekanizëm juridik para Gjykatës Supreme paraqitet në nenin 36 të Ligjit për gjykatat. Njëkohësisht, të njëjtat kritere për vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave vendore janë përfshirë në praktikën gjyqësore të Gjykatës supreme.

Pilot vendimet e para të GJEDNJ-së që nuk adresojnë rrethanat e një lënde të veçantë, por shkeljet sistematike të Konventës në një vend të caktuar, u miratuan pikërisht në lidhje me problemin sistematik të zgjatjes së tepruar të procedurave vendore (Kudła v. Poland, §§ 119-131). Në pajtim me nenin 6 të Konventës, shkaktohet detyrim pozitiv për shtetin sipas nenit 13 të KEDNJ-së, për të krijuar mjet juridik që do të përshpejtonte procedurat e zgjatura për qëllimet e nenit 6 (Kudła v. Poland).

75 Ibid, paragrafi 314

76 Council of Europe, Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights: Right to a Fair Trial (civil limb), Updated on 31 August 2020, [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_ENG.pdf), paragrafi 442

77 Ibid, paragrafi 446

78 Ibid, paragrafi 447



Parimet e përgjithshme dhe standardet e vendosura përmes praktikës së GJEDNJ-së zbatohen në vendimet dhe aktgjykimet përkatëse maqedonase para GJEDNJ-së. Ndër to, më i rëndësishëm është pilot vendimi në lëndën Axhi-Spirkoska dhe të tjerët dhe Ilço Topuzovski me të cilën kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat kohor të arsyeshëm para Gjykatës Supreme u shpall si mjet juridik efektiv që kërkuesit duhet detyrimisht të absolutojnë përpara se të aplikojnë, përkatësisht para se të paraqesin kërkesë në Strasburg, përmes së cilës ata do të ankoheshin për një shkelje të pretenduar të së drejtës për gjykim në afat kohor të arsyeshëm.

## 1.4 STANDARDET E RËNDËSISHME PËR ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Lidhur me rolin e administratës gjyqësore, është thelbësor **Opinion nr.22 (2019) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE) për rolin e ndihmësve të gjykatës**.<sup>79</sup> Aty thuhet se "kur gjyqtarët në procesin gjyqësor mbështeten nga asistentët, cilësia dhe efikasiteti i punës së tyre mund të rritet më tej në interes të shoqërisë dhe palëve në procedurë".<sup>80</sup>

Në këtë mënyrë, termi asistentë të gjykatës duhet të kuptohet në një kuptim më të gjerë të fjalës si ndihmës ekspertë gjyqësorë, këshilltarë të gjykatës dhe anëtarë të tjerë të administratës së gjykatës, të cilët "kanë arsimim juridik dhe mbështesin gjyqtarët ose këshillat gjyqësorë në punën e tyre ligjore. Asistentët gjyqësorë ndërmarrin një gamë të gjerë detyrash të tilla si kërkimi, hartimi i shkresave për çështje juridike ose hartim i aktgjykimeve".<sup>81</sup> Ky opinion nuk i përfshin vetëm asistentët administrativë, megjithëse ata shpesh punojnë ngushtë me gjyqtarët dhe "[edhe] pse mund të ketë një mbivendosje të konsiderueshme midis punës së tyre dhe punës së asistentëve të gjykatës".<sup>82</sup>

Opinionin vë në dukje se asistentët e gjykatave mund të luajnë një rol të rëndësishëm në uljen e ngarkesës së gjyqtarëve nga detyrat jashtëgjyqësore, me qëllim që të shpejtohet puna e gjyqtarëve dhe të ulet numri i lëndëve të prapambetura, si dhe për t'i ndihmuar ata të përgatisin vendime me cilësi të lartë, me çka asistentët e gjykatave mund të paraqesin instrument të rëndësishëm në përmirësimin e efikasitetit të gjyqësorit.<sup>83</sup> Për këtë qëllim, shtetet kanë përgjegjësi të sigurojnë mjete financiare përveç për emërimin e gjyqtarëve të mjaftueshëm dhe punësimin e personelit të kualifikuar gjyqësor, përfshirë asistentët gjyqësorë.

Përndryshe, dhe paraprkisht në Opinionin nr. 6 (2004) përmendet se sa e rëndësishme është në drejtim të efikasitetit në punën e gjyqtarëve që të lirohen nga kryerja e detyrave të papërshtatshme dhe tu sigurohen asistentë, të cilët do të kenë kualifikime thelbësore në fushën juridike, si bashkëpunëtorë profesionistë, të cilëve gjyqtarët mund t'u delegojnë, nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e tyre, kryerjen e veprimtarive specifike siç janë kërkimi i legjislacionit dhe praktikës gjyqësore, shkrimi i dokumenteve më të thjeshta ose të standardizuara dhe lidhja me avokatët dhe / ose publikun.<sup>84</sup>

79 Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No.22 (2019) of the Consultative Council of European Judges (CCJE) on the Role of Judicial Assistants, Strasbourg, 7 November 2019, CCJE (2019)6

80 Paragrafi 1

81 Paragrafi 4

82 Paragrafi 6

83 Paragrafi 13

84 Paragrafi 65

Nëse ngarkesa e punës së gjyqtarëve është shumë e madhe, mund të rrisë presionin t'u delegojnë më shumë detyra asistentëve të gjykatës,<sup>85</sup> të cilët, duke pasur parasysh se përmes mbështetjes së vendimmarrjes së gjyqtarëve përfshihen në kryerjen e detyrave gjyqësore, duhet të veprojnë në përputhje me standardet më të larta profesionale dhe etike dhe në këtë mënyrë të ndihmojnë në ndërtimin e besimit të lartë të publikut në institucionet gjyqësore.<sup>86</sup>

Duke pasur parasysh që asistentët me sugjerimet e tyre mund të ndikojnë në mendimin e gjyqtarëve kur atyre u është besuar detyra të përgatisin punim, për atë se si duhet të vendoset për lëndë të caktuara, kjo nuk duhet ta parandalojë gjyqtarin që të njihet me lëndën edhe në atë kuptim gjyqtarëve u kërkohet në çdo kohë të qëndrojnë të përgjegjshëm për aktgjykimet e tyre.<sup>87</sup> Njëkohësisht, nëse asistentëve të gjykatës u jepet mundësia të punojnë në mënyrë të pavarur në lëndën, detyrimisht duhet të kërkohet aprovimi për vendimet e përgatitura nga gjyqtari, i cili duhet të mbikëqyrë drejtpërdrejt vendimin e përgatitur.<sup>88</sup> Në mënyrë që të shmangët rreziku asistentët gjyqësor që të ndikojnë mbi përzgjedhjen e lëndëve (që, nga ana tjetër, lejon gjyqtarët e gjykatave supreme dhe gjyqtarëve Kushtetues të përqendrohen në lëndë të rëndësishme ndërsa asistentët punojnë në lëndë të përsëritura, rutinë) kërkohet që të sigurohet që vetë gjyqtarët të kenë kontroll mbi vendimmarrjen dhe përzgjedhja e lëndëve.<sup>89</sup>

Për më tepër, asistentët gjyqësorë gjithashtu mund të kontribuojnë në transparencën e gjyqësorit duke kontribuar në përgatitjen, nën mbikëqyrjen e gjyqtarëve, të përmbledhjeve të vendimeve gjyqësore ose informacionit mbi seancat e destinuar për media.<sup>90</sup>

Duke marrë parasysh që në disa vende asistentëve gjyqësorë u jepen edhe detyra administrative si mbajtja e procesverbalit zyrtar të gjykimeve, organizimi i regjistrave gjyqësorë dhe korrespondenca me palët, përgatitja e kopjeve zyrtare të vendimeve, etj.,<sup>91</sup> cthekohet nevoja për rregulla ose udhëzime që do të informojnë gjyqtarët dhe ndihmësit e gjykatave për llojin e lëndëve që mund t'u delegohen atyre, gjithnjë me qëllim të krijohet transparencë dhe llogaridhënie në lidhje me përfshirjen e pranueshme të asistentëve të gjykatës në procesin e vendimmarrjes.<sup>92</sup>

Lidhur me zgjedhjen e asistentëve të gjykatave, rekomandohet që gjyqësori të jetë përgjegjës ekskluziv, në vend të pushtetit ekzekutiv dhe zgjedhja të zhvillohet përmes një procedure transparente bazuar në kriteret dhe meritat objektive (i ashtuquajturit sistemi i meritës).<sup>93</sup>

85 Paragrafi 14

86 Paragrafi 19

87 Paragrafi 26

88 Paragrafi 27

89 Paragrafi 28

90 Paragrafi 32

91 Paragrafi 33

92 Paragrafi 34

93 Paragrafët 42 dhe 43

Duke pasur parasysh praktikat e ndryshme në vendet në lidhje me periudhën kohore për të cilën janë punësuar asistentët e gjykatave,<sup>94</sup> përparësi të shumta duhet të merren parasysh nëse asistentët e gjykatave me përvojë mbahen për një periudhë më të gjatë (kjo mund t'i bëjë gjykatat më efikase, pasi ndryshimet e shpeshta nënkuptojnë që asistentët e rinj do të duhet të trajnohen dhe do t'ju duhet kohë për të hyrë në punë, ndryshe nga asistentët me përvojë të cilët mund të kursejnë kohë dhe të punojnë në mënyrë më të pavarur në lëndë rutinë), si dhe disavantazhet në kuptimin që nëse fitojnë shumë përvojë ata mund të kenë shumë ndikim mbi procesin ligjor që do të ishte problematik në lidhje me garancitë e nenit 6. nga KEDNJ. Nga ana tjetër, ndryshimet e rregullta të asistentëve të gjykatave mund të ndihmojnë gjykatat dhe gjyqtarët të qëndrojnë më dinamikë dhe të azhurnuar me trendet e reja.<sup>95</sup> Prandaj është e këshillueshme që shtetet të vendosin një ekuilibër midis këtyre avantazheve dhe disavantazheve në mënyrë që koha e angazhimit të tyre të mos jetë as shumë e gjatë dhe as shumë e shkurtër për të siguruar që ata të mund të sigurojnë mbështetje cilësore për punën e gjyqtarëve.<sup>96</sup>

Në të njëjtën kohë, theksohet nevoja të mundësohen trajnime dhe fitimi i titujve më të lartë për asistentët gjyqësorë me përvojë, në mënyrë që të mundësohet avancimi i tyre, përfshirë përmes shqyrtimit të mundësisë për avancimin e tyre në pozita më të larta në administratën e gjykatës ose në gjykatat më të larta,<sup>97</sup> përkatësisht, ata duhet të inkurajohen dhe mbështeten të bëhen gjyqtarë, gjë që do të lejonte që sistemi i drejtësisë të mbështetet te kandidatët që kanë një njohuri gjithëpërfshirëse të detyrave dhe rolit të gjyqtarit. Mbindërtimi i përvojës së tyre mund të zvogëlojë nevojën për trajnim dhe të ndihmojë zhvillimin e një sistemi gjyqësor efektiv.<sup>98</sup> Në atë kuptim, vlerësimi i tyre nga gjyqtari, përkatësisht gjyqtarët me të cilët kanë punuar, është i domosdoshëm, si parakusht për zhvillimin e karrierës së tyre të mëtejshme, i cili vlerësim duhet të kryhet sipas kriterëve objektive që do të marrin parasysh kompetencën e tyre juridike, integritetin, motivimin dhe efikasitetin, dhe në procesin e vlerësimit do të dëgjohej edhe mendimi i tyre.<sup>99</sup>

94 Paragrafi 45

95 Paragrafi 46

96 Paragrafi 49

97 Paragrafi 47

98 Paragrafi 48

99 Paragrafi 50

# 2.

Politikat kombëtare  
dhe korniza juridike  
e transparencës,  
llogaridhënies  
dhe efektivitetit  
të gjyqësorit,  
me fokus në punën e  
administratës gjyqësore

---

Ky kapitull adreson politikat kombëtare dhe kornizën juridike në lidhje me transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e gjyqësorit me një fokus të veçantë tek gjyqtarët. Zbatimi i këtyre parimeve është i rëndësishëm për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Sipas Ligjit për gjykatat, gjyqtarët mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut në zbatimin e ligjit. Gjykatat gjykojnë dhe bazojnë vendimet e tyre në Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.<sup>100</sup>

Me këtë respektohen qëllimet dhe funksionet e pushtetit gjyqësor: zbatimi i paanshëm i ligjit pavarësisht nga pozicioni dhe kapaciteti i palëve, mbrojtja, respektimi dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, sigurimi i barazisë, mosdiskriminimi mbi çfarëdo bazë dhe sigurimi i sigurisë juridike bazuar në shtetin e së drejtës.<sup>101</sup> Secili ka të drejtë për qasje të barabartë para gjykatës në mbrojtje të të drejtave të tij dhe interesat mbi baza ligjore.<sup>102</sup>

Kjo pjesë i analizon parimet e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të punës së gjykatësve nga aspekti i rregullimit të tyre me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Ligjin për gjykata, Ligjin për Këshillin gjyqësor, Ligjin për procedurën penale, Ligjin për procedurën kontestimore, Ligjin për menaxhimin me lëvizjen e lëndëve gjyqësore, si dhe krahasim përmes raporteve dhe rekomandimeve nga institucionet vendase dhe organizata ndërkombëtare.

100 TEKSTI I KONSOLIDUAR Ligji për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë: U. nr. 256/2007 të 16 prillit 2008, botuar në "Gazeta Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 61/2008; Y. nr. 74/2008 të 10 shtatorit 2008, botuar në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 118/2008; Y. nr. 124/2008 të 14 janarit 2009, botuar në "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/2009 dhe U. nr. 12/2011 të 29 Shkurt 2012, botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 39/2012. Ligji për përdorimin e gjuhës që flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 101/2008).

101 Ibid

102 Ibid

## 2.1 TRANSPARENCA NË PUNËN E GJYQTARËVE

Transparenca në punën e gjyqtarëve është e rëndësishme nga aspekti i vetë punës si gjyqtar, përkatësisht zhvillimi publik i seancave dëgjimore dhe publiciteti në vendimet e marra, si dhe nga aspekti i punës së vetë institucioneve, përkatësisht si punojnë gjykatat dhe Këshilli Gjyqësor.

Publiciteti në punën e gjyqtarëve garantohet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut<sup>103</sup> e cila thotë se seanca dëgjimore para gjykatave dhe shpallja e aktgjykimit janë publike. Publiku mund të përjashtohet në rastet e përcaktuara me ligj. Ligjet procedurale, mbi të gjitha Ligji për procedurë kontestimore (LPK)<sup>104</sup> dhe Ligji për procedurën penale (LPP)<sup>105</sup> garantojnë publikun në procedurë, duke specifikuar rastet në të cilat publiku mund të përjashtohet.

BNë procedurat kontestimore, në përputhje me LPK-në<sup>106</sup>, Këshilli mund të përjashtojë publikun nga e gjithë seanca dëgjimore kryesore ose nga një pjesë e saj nëse: këtë e kërkojnë interesat e mbajtjes së sekretit zyrtar, afarist ose personal, interesat e rendit publik ose arsyet e moralit, si dhe në rastin kur me masat e mbajtjes së rendit nuk mund të sigurohet mbajtja e pa penguar e seancës. Përjashtimi i publikut nuk vlen për palët, përfaqësuesit e tyre ligjorë, të autorizuarit dhe ndërmjetësuesit. Këshilli mund të lejojë në seancën kryesore në të cilën përjashtohet publiku të marrin pjesë persona zyrtarë të caktuar, si dhe punonjës shkencorë dhe publikë, nëse kjo është me interes për shërbimin e tyre, përkatësisht veprimtarinë shkencore ose publike. Aktvendimi për përjashtimin e publikut duhet të arsyetohet dhe të bëhet publik. Asnjë ankesë e veçantë nuk lejohet kundër këtij aktvendimi, por përjashtimi i publikut, në kundërshtim me ligjin, përbën një shkelje thelbësore të procedurës dhe palët mund të paraqesin revizion si një mjet juridik të jashtëzakonshëm.

Parimi i publicitetit është një nga parimet themelore të procedurës penale. Seanca kryesore është publike<sup>107</sup>, ndërsa këshilli mund të përjashtojë publikun në çdo kohë deri në përfundimin e seancës kryesore sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palëve në disa raste: për shkak të ruajtjes së sekretit shtetëror, ushtarak, zyrtar ose sekretit të

103 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 102.

104 Teksti i konsoliduar i Ligjit për Procedurën kontestimore, i cili përfshin: tekstin bazë të Ligjit, botuar në "Gazeta Zyrtare e RM" nr.79/05, Ligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën kontestimore, botuar në "Gazetën Zyrtare të RM" nr.110/08, Ligji për plotësimin e Ligjit për Procedurën kontestimore, botuar në "Gazetën Zyrtare të RM" nr.83/09, Ligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën kontestimore, botuar në "Gazetën Zyrtare të RM" nr.116/10, Ligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën kontestimore, botuar në "Gazetën Zyrtare të RM" nr.124/15, të cilat tregojnë kohën e hyrjes në fuqi dhe zbatimit të tyre, neni 4.

105 Ligji për Procedurën Penale.

106 Teksti i konsoliduar editorial i Ligjit për Procedurën kontestimore, neni 293

107 Ligji për Procedurën Penale, Neni 253.

rëndësishëm afarist; ruajtja e rendit publik; mbrojtja e jetës private të të akuzuarit, dëshmitarit ose palës së dëmtuar; mbrojtja e sigurisë së dëshmitarit ose viktimës; dhe / ose mbrojtjen e interesave të të miturit. Përjashtimi i publikut nuk vlen për palët, të dëmtuarin, si dhe mbrojtësin, përveç në rastet e përcaktuara me ligj.

LPP shkon një hap më tej dhe neni 126 rregullon qasjen në vendimet gjyqësore. Të gjitha aktgjykimet në procedurat penale janë publike dhe të qasshme në kopje elektronike ose të shtypur, përveç në rastet kur publiku përjashtohet. Vendime të tjera gjyqësore janë në dispozicion për këqyrje dhe transkriptim për çdo person të interesuar, përveç në rastet kur publiku përjashtohet.

Kjo zgjidhje ligjore është në përputhje me Rezolutën për Transparencë dhe Qasje në Drejtësi<sup>108</sup>, e cila përcakton që vendimet e gjykatës duhet të jenë të arsyetuara qartë dhe publike. Mbrojtja e të dhënave personale, privatësia, siguria personale dhe konfidencialiteti duhet të merren parasysh gjatë publikimit. Njëkohësisht, sipas Rekomandimeve nga Kievi për ODIHR-in<sup>109</sup>, në mënyrë që të rritet përgjegjësia profesionale dhe publike e gjyqtarëve, vendimet gjyqësore duhet të publikohen në internet, në bazat e të dhënave dhe në ueb faqet, në një mënyrë që do të jenë në dispozicion falas. Pastaj, në mënyrë që të sigurohen prova për sjelljen e gjyqtarit në sallën e gjyqit dhe për saktësinë e procedurave të gjykatës, seancat gjyqësore duhet të incizohen me pajisje elektronike që mundësojnë riprodhimin e plotë<sup>110</sup>. Ndërsa për pjesën e parë të rekomandimit mund të konkludohet se publikimi i aktgjytimeve dhe vendimeve është respektuar, ka ende punë për të bërë në lidhje me publikimin e vendimeve në internet dhe në bazat e të dhënave.

Sipas këtyre rekomandimeve, transparenca gjithashtu i referohet vendimeve që vendosen në procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë së një gjykatësi ose kryetarit të një procedure disiplinore gjyqësore. Procedura është urgjente dhe konfidenciale dhe zhvillohet pa praninë e publikut, me respektimin e reputacionit dhe dinjitetin e gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, si dhe me mbrojtjen e të dhënave personale të gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale. Këshilli mund të vendosë që procedura të jetë publike, me kërkesë të gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës kundër së cilës zhvillohet procedura<sup>111</sup>. Megjithëse publiku është i përjashtuar nga seancat për përcaktimin e përgjegjësisë së një gjykatësi ose kryetari gjykate, vendimet me shpjegimin e të njëjtës publikohen në ueb faqen e Këshillit Gjyqësor, gjatë çka mbrojtja e të dhënave personale të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës, është respektuar.

Sipas rekomandimeve të Kievit, transparenca vlen edhe për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës. Konkursi për zgjedhje duhet të shpallet me mundësinë për të aplikuar të gjithë

108 Resolution on Transparency and Access to Justice, Adopted in Bucharest (RO), European Network of the Councils for the Judiciary. Në dispozicion në: [https://www.enj.eu/images/stories/pdf/opinions/resolutionbucharest29may\\_final.pdf](https://www.enj.eu/images/stories/pdf/opinions/resolutionbucharest29may_final.pdf).

109 Kyiv recommendations on Judicial independence in Eastern Europe, South Caucasus and Central Asia, Judicial Administration, Selection and Accountability - OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights and Max Planck Minerva Research Group on Judicial Independence Kyiv, 2010, стр. 6. Në dispozicion në: <http://www.osce.org/odihr/kyivrec?download=true>.

110 Ibid

111 Ligji për Këshillin Gjyqësor të RMV, neni 61.



aplikantët që plotësojnë kushtet. Përzgjedhja mund të bëhet nga një trup këshillimor ose nga vetë gjyqtarët e gjykatës. Për zgjedhjen e kryetarit të një gjykate në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Këshilli Gjyqësor shpall një shpallje dhe zgjedh kryetarin e gjykatës nga kandidatët e paraqitur.<sup>112</sup> Këshilli Gjyqësor do të zgjedhë një kryetar i cili plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Ligjin për gjykatat. Njëkohësisht, secili anëtar i Këshillit me të drejtë vote është i detyruar të shpjegojë me gojë vendimin e tij / saj për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës, në seancë të Këshillit. Nga këto dispozita mund të konkludohet se transparenca është respektuar në zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës dhe në përputhje me Rekomandimet e Kievit.

Për të rritur besimin e publikut në gjykata, qasja e gazetarëve në gjykatë duhet të inkurajohet dhe të caktohet një nëpunës për media.<sup>113</sup> Informacione për publikun përmes mediave në lidhje me punën e gjykatës, si dhe informacione në lidhje me rrjedhën e procedurës për një lëndë specifike, sigurohet nga kryetari i gjykatës, përgjegjës për marrëdhëniet me publikun. Formimi i zyrës për marrëdhënie me publikun në gjykatat është i detyrueshëm. Kryetari i gjykatës dhe gjyqtari i ngarkuar sigurojnë informacione për publikun duke u kujdesur që të mos njollosin reputacionin, nderin dhe dinjitetin e personit dhe nëse nuk është në dëm të pavarësisë së gjykatës. Secila gjykatë të paktën një herë në vit informon publikisht publikun për rezultatet e punës së gjykatës dhe gjyqtarëve. Gjithashtu, të dhënat për numrin e lëndëve, gjyqtarin, datën, orën dhe sallën e gjykimit në të cilën zhvillohet seanca publikohen çdo ditë në një vend publik dhe të dukshëm.<sup>114</sup>

Gazetarët- raportues dhe qytetarët gjithashtu mund të marrin pjesë në seancat dëgjimore publike para gjykatave pa pasur nevojë të marrin leje paraprake nga gjykatë. Kushtet për punën e tyre Gjykata siguron kushte për praninë dhe punën e tyre. Incizimi vizual (video) dhe me zë (audio), raportimi dhe fotografimi në procedurat penale dhe paraqitja publike (riprodhimi) i regjistrimit kryhet me miratimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, pas marrjes së mendimit nga Kryetari i Këshillit, gjyqtarët. Jashtë gjykimit, incizimi dhe fotografimi në ndërtesën e gjykatës mund të kryhet me lejen e kryetarit të gjykatës që administron ndërtesën.<sup>115</sup>

Për më tepër, publikimi i njoftimeve dhe shpalljeve të gjykatës bëhet në tabelë njoftimesh të vendosur në vend të dukshëm në gjykatë dhe në ueb faqen e gjykatës. Çdo ditë para hyrjes në ambientet ku zhvillohet gjykimi, shfaqet një listë e gjykimeve të planifikuara për atë ditë, ku shënohet: renditja e gjykimeve të planifikuara, numri dhe baza e lëndës, koha e gjykimit dhe salla ku mbahet gjykimi. Kjo listë publikohet edhe në mënyrë elektronike në ekran në korridoret e gjykatës dhe në ueb faqen e gjykatës.<sup>116</sup>

112 Ligji për Këshillin Gjyqësor të RMV, neni 51.

113 Kyiv recommendations on Judicial independence in Eastern Europe, South Caucasus and Central Asia, Judicial Administration, Selection and Accountability - OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights and Max Planck Minerva Research Group on Judicial Independence Kyiv, 2010. Në dispozicion në: <http://www.osce.org/odihr/kyivrec?download=true>

114 Ligji për gjykatat, neni 97.

115 Rregullorja e gjykatës, neni 104.

116 Rregullorja e gjykatës, neni 122.

Duke pasur parasysh rolin e Këshillit Gjyqësor si organ përgjegjës për zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve, transparenca në punën e Këshillit Gjyqësor është gjithashtu e rëndësishme. Kjo i referohet kryesisht publikut në seancat, publikimit të vendimeve për zgjedhje dhe shkarkim në ueb faqen e Këshillit Gjyqësor, publikimit të raporteve vjetore për punën e gjykatave, publikimit të prokurimeve publike dhe të tjera. Seancat e Këshillit Gjyqësor janë të hapura për monitorimin përkatësisht për mbikëqyrjen e punës së tij. Vendimet për zgjedhje dhe shkarkim publikohen në ueb faqen e Këshillit Gjyqësor, si dhe raportet vjetore për punën e gjykatave. Ndërsa vendimet e publikuara për shkarkim përmbajnë arsyetim, vendimet për zgjedhjen janë pa arsyeime dhe publiku nuk mund të informohet për arsyet e zgjedhjes së një personi si gjyqtar ose kryetar të një gjykate.

## 2.2 PËRGJEGJËSIA NË PUNËN E GJYQTARËVE

Përgjegjësia e gjyqtarëve për punën e tyre si bartës së pushtetit të tretë është një nga bazat e një shoqërie demokratike. Përgjegjësia lidhet drejtpërdrejt edhe me kryerjen e duhur të funksionit të tyre: "Gjykatësit në zbatimin e ligjit mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut".<sup>117</sup> Rëndësia e funksionit gjyqësor theksohet nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me dispozitën se funksioni gjyqësor nuk mund të lidhet me kryerjen e një funksioni dhe profesioni tjetër publik ose me anëtarësimin në parti politike. Ndalohej organizimi dhe veprimi politik në gjyqësor.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 13, garanton se "Person i akuzuar për vepër penale do të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të përcaktohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor. Personi i privuar nga liria në mënyrë të paligjshme, i arrestuar ose i dënuar në mënyrë të paligjshme, ka të drejtën e kompensimit të dëmit dhe të drejtave të tjera të përcaktuara me ligj." Kjo dispozitë vë në lidhje të drejtpërdrejtë llogaridhënien e gjyqtarëve për dëmet e shkaktuara gjatë procedurave gjyqësore.

Njëkohësisht, gjyqtarët gëzojnë imunitet në kryerjen e funksioneve të tyre gjyqësore. Gjyqtari nuk mund të thirret në përgjegjësi penale për një mendim të shprehur dhe vendim gjyqësor që ka marrë, gjithashtu nuk mund të arrestohet pa miratimin e Këshillit Gjyqësor, përveç nëse ai / ajo kapet duke kryer një vepër penale për të cilën përcaktohet dënim me burg në kohëzgjatje prej të paktën pesë vjet. Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë vendos për heqjen e imunitetit të gjyqtarëve, në procedurë urgjente.<sup>118</sup>

### 2.2.1. Kriteret e shkarkimit

Përgjegjësia individuale konsiderohet në kuptim të përgjegjësisë së gjyqtarëve në lidhje me kryerjen joprofesionale dhe neglizhencë të funksionit gjyqësor, si dhe gjatë shkeljeve disiplinore.

Kriteret për shkarkimin e gjyqtarit përcaktohen saktësisht dhe numërohen në mënyrë taksative.<sup>119</sup> Përveç kësaj, gjyqtari mund të shkarkohet nëse këtë e kërkon vetë, nëse humbet përgjithmonë aftësinë për të kryer funksionin gjyqësor, që përcaktohet nga Këshilli Gjyqësor, nëse plotëson kushtet për pensionin e pleqërisë dhe nëse është dënuar për vepër penale me dënim me burgim të pakushtëzuar, për të paktën gjashtë muaj, mund të shkarkohet edhe për arsye që lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e funksionit gjyqësor:

117 Ligji i Konsoliduar për gjykatat, neni 2 (2).

118 Ligji për Këshillin Gjyqësor, neni 65.

119 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 99.

- » për shkak të shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuar me ligj që e bën të pa denjë për kryerjen e funksionit gjyqësor, i cili përcaktohet nga Këshilli Gjyqësor; dhe
- » për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pa përgjegjshme të funksionit gjyqësor, i cili në procedurë të përcaktuar me ligj, përcaktohet nga Këshilli Gjyqësor, përveç dënimit për vepër penale me burgim të pakushtëzuar të paktën gjashtë muaj.

Këshilli Gjyqësor është organi që është kompetent për procedurën e shkarkimit nga funksioni gjyqësor në rastet e përcaktuara me Kushtetutë; vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve; vlerëson ekspertizën dhe ndërgjegjshmërinë e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre.<sup>120</sup>

Parashtresat me shkrim për shkak të sjelljes së pahijshme ose sjelljes së papërshtatshme të gjyqtarit në marrëdhëniet zyrtare me palët i paraqiten kryetarit të gjykatës. Parashtresat në lidhje me ushtrimin e funksionit gjyqësor duhet të shqyrtohen shpejt, në mënyrë të drejtë dhe pa prani të publikut në procedurë.<sup>121</sup> Megjithatë, nuk mund të mbahet procedurë për dëmshpërblim ose procedurë tjetër nga një palë e cila është e pakënaqur me vendimin e gjyqtarit. Me këtë dispozitë sigurohet garanci dhe mbrojtje e pavarësisë së gjyqtarit gjatë zhvillimit të procedurës dhe vendimarrjes.

Në Ligjin për gjykatat përcaktohet se çfarë nënkuptohet si shkelje disiplinore, shkelje disiplinore më e rëndë dhe kryerje joprofesionale dhe neglizhencë gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor. Gjyqtari shkarkohet nga pozita e gjyqtarit nëse shkelja është kryer me dashje ose neglizhencë të dukshme për faj të gjyqtarit pa arsye të justifikuara dhe nëse dëmi ka shkaktuar pasoja të rënda. Në rast të dëmtimit të formës më të vogël, gjyqtarit mund t'i shqiptohet masë disiplinore.<sup>122</sup>

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së një gjyqtari ose kryetari të një gjykate (në tekstin e mëtejshëm: procedura) fillon brenda gjashtë muajve nga dita e zbulimit të shkeljes, por jo më vonë se tre vjet nga dita e kryerjes së shkeljes. Procedura është urgjente dhe konfidenciale dhe zhvillohet pa praninë e publikut, me respektimin e reputacionit dhe dinjitetin e gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, gjatë çka mbahet llogari për mbrojtjen e të dhënave personale të gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale. Me kërkesë të gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, Këshilli do të vendosë që procedura të jetë publike.

Shkelja më e rëndë disiplinore, për të cilën fillohet procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit, konsiderohet:

1. shkelje serioze e rendit dhe qetësisë publike dhe forma të tjera më serioze të sjelljes së keqe që dëmtojnë reputacionin e gjykatës dhe reputacionin e tij;
2. ndikimi i ashpër dhe ndërhyrje në kryerjen e funksionit gjyqësor të një gjyqtari tjetër;
3. nëse refuzon të paraqesë deklaratë të statusit të pronës dhe interesave në përputhje me ligjin ose nëse të dhënat e përfshira në deklaratë janë kryesisht të pavërteta ose

120 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 105.

121 Ligji për Këshillin Gjyqësor, neni 68.

122 Ligji i Konsoliduar për gjykatat, neni 74.

4. shkelje e dukshme e rregullave të përjashtimit në situata në të cilat gjyqtari ka ditur ose duhej të dinte për ekzistencën e ndonjë prej arsyeve të përjashtimit të parashikuara me ligj.<sup>123</sup>

Në rastet që kanë të bëjnë me shkelje serioze të rendit publik dhe forma të tjera më serioze të sjelljes së keqe që dëmtojnë reputacionin e gjykatës dhe reputacionin e gjykatësit, kur është marrë vendim gjyqësor, gjykata që ka marrë vendimin është e detyruar menjëherë pasi vendimi të jetë i plotfuqishëm të njoftojë me shkrim Këshillin Gjyqësor dhe kryetarin e gjykatës ku gjyqtari kryen funksionin gjyqësor. Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë për këtë lloj shkelje mund të iniciohet edhe kur nuk është miratuar vendim i plotfuqishëm gjyqësor.

Ligji për Gjykatat përcakton kryerjen joprofesionale dhe pa kujdes të funksionit gjyqësor si ekspertizë të pakënaqshme ose neglizhencë të gjyqtarit që ndikon në cilësinë dhe afatet kohore të punës, nëse:

1. në dy vlerësime të njëpasnjëshme nuk plotëson kriteret e suksesit në punë, me faj të gjyqtarit pa arsye të justifikuara, për të cilat vlerësohet me dy vlerësime negative, në përputhje me procedurën e përcaktuar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë;
2. është dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me dënim më të ulët se ai i parashikuar në nenin 73 paragrafi (1) alineja 5 të këtij ligji, i cili është rezultat i drejtpërdrejtë i veprimit në kryerjen e funksionit gjyqësor, me dashje ose për ushtrim të funksionit neglizhencë të qëllimshme;
3. në mënyrë të pa autorizuar ka lëshuar informacione të klasifikuara, përkatësisht ka nxjerrë informacione dhe të dhëna për lëndët gjyqësore, me çka shkelet detyrimi për mbrojtjen e procedurës së fshehtë të përcaktuar me ligj dhe kur publiku përjashtohet në përputhje me ligjin;
4. pa shkaqe të arsyeshme nuk cakton seancat dëgjimore për lëndët që i janë caktuar në punë ose në mënyrë tjetër vonon procedurën;
5. nuk e merr lëndën në punë për shkak të së cilës ekziston parashkrimi i ndjekjes penale ose parashkrimi i ekzekutimit të sanksionit penal për vepër penale;
6. merr përsipër lëndë që nuk i është caktuar përmes sistemit të automatizuar kompjuterik për menaxhimin e lëndëve gjyqësore në gjykata;
7. qëllimisht dhe në mënyrë të padrejtë bën gabim të madh profesional, ku interpretimi i ndryshëm i ligjit dhe fakteve nuk mund të jetë bazë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit.<sup>124</sup>

Si shkelje disiplinore për të cilën fillohet procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit për të cilin do të shqiptohet masë disiplinore konsiderohet:

1. shkelje më e lehtë e rendit dhe qetësisë publike ose formë tjetër më e lehtë e sjelljes së keqe që dëmton reputacionin e gjykatës dhe reputacionin e gjyqtarit;

<sup>123</sup> Ligji i Konsoliduar për gjykatat, neni 75.

<sup>124</sup> Ligji i Konsoliduar për gjykatat, neni 76.

2. shfrytëzim të funksionit dhe reputacionit gjyqtar dhe të gjykatës për të arritur interesat e veta private;
3. mos-përbushje e detyrave të mentorimit;
4. shkelje e rregullave për mungesë në punë;
5. mos marrja pjesë në trajnimet e detyrueshme ose
6. mos veshja e veshjes gjyqësore gjatë gjykimeve.<sup>125</sup>

Kryetari i gjykatës është i detyruar të njoftojë Këshillin Gjyqësor me shkrim për shkeljen disiplinore brenda tetë ditëve nga dita e njoftimit për kryerjen e shkeljes, por jo më gjatë se gjashtë muaj nga kryerja e shkeljes. Masa disiplinore shqiptohet nëse:

- » shkelja disiplinore është kryer me dashje ose neglizhencë të dukshme për faj të gjyqtarit pa arsye të justifikuar dhe;
- » shkelja disiplinore ka shkaktuar pasoja të rënda.<sup>126</sup>

Vendimi për shkarkimin e gjyqtari publikohet në ueb faqen e Këshillit Gjyqësor, me arsyetim të fakteve që rezultuan të merret ky vendim. Njëkohësisht, për dëmin eventual që gjyqtari do të shkaktojë qytetarëve ose personave juridik me punën e vet të paligjshme, përgjigjet Republika e Maqedonisë së Veriut. Kur për shkak të dëmit të bërë gjyqtari shkarkohet, Republika e Maqedonisë përmes padisë do të kërkojë nga gjyqtari i shkarkuar kthimin e shumës së dëmit të paguar, në lartësinë që do të përcaktohet nga gjykata, në përputhje me ligjin.

Përveç llogaridhënies individuale për punën e gjyqtarëve, llogaridhënia gjithashtu shihet përmes punës së Këshillit Gjyqësor dhe raporteve për punën e tij. Raportet vjetore të punës përmbajnë të dhënat e kërkuara nga ligji, siç janë numri i gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë të zgjedhur dhe të shkarkuar, numri i procedurave disiplinore, personeli dhe gjendja materiale-financiare, numri i lëndëve, bashkëpunimi me organe të tjera, por ato ofrojnë kryesisht informacion statistikor.

Lidhur me kërkesat e paraqitura për përcaktimin e përgjegjësisë për gjyqtar ose kryetar gjykate, gjatë vitit 2020, kërkesat janë dorëzuar kundër 140 gjykatësve, përkatësisht 58 kërkesa. Komisioni i Raportuesve refuzoi 44 kërkesa, 1 procedurë u ndalua. Për 1 gjyqtar është përcaktuar shkelje disiplinore dhe është lëshuar vërejtje me shkrim, 1 (një) kërkesë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit është tërhequr nga paraqitësi. Këshilli mori vendime për shkarkimin e 5 (pesë) gjyqtarëve për shkak të kryerjes joprofesionale të funksionit gjyqtar, si më poshtë: - 2 (dy) gjyqtarë për procedurat e filluara në vitin 2019 dhe - 3 (tre) gjyqtarët për procedurat e filluara në vitin 2018.<sup>127</sup> Pyetja është nëse mjafton vetëm paraqitja statistikore, se sa kërkesa për përgjegjësi të gjyqtarëve janë paraqitur, pa të dhëna se për çfarë i referohen kërkesa, është e mjaftueshme të plotësohet llogaridhënia përgjegjësinë ndaj qytetarëve në raportet vjetore.

125 Ligji i Konsoliduar për gjykatat, neni 77.

126 Ligji i Konsoliduar për gjykatat, neni 78.

127 Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020.

Komisioni Evropian në Raportin e Progresit për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2020, veçanërisht thekson faktin se Këshilli Gjyqësor i hoqi imunitetin një prej anëtarëve të tij i cili është i dyshuari kryesor në lëndën në lidhje me privatizimin e paligjshëm të tokës ndërtimore, por nuk lejoi arrestimin e tij, dhe i hoqi imunitetin gjyqtarit. Thekson se Këshilli i ri i Etikës Gjyqësore është themeluar sipas Kodit të ri të Etikës, por edhe se shkelja e Kodit të Etikës nuk është shënuar si bazë për procedurat disiplinore në Ligj.<sup>128</sup>

Zgjidhjet ligjore në lidhje me përgjegjësinë e gjyqtarëve janë në përputhje me Opinionin nr. 3 të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarit Evropian, ku rekomandohet me statut ose një konventën fundamentale duhet të përcaktojë sa më saktë që të jetë e mundur, cilat lëshime mund të jenë subjekt i sanksioneve disiplinore, cilat do të jenë procedurat, dhe se duhet të ketë një organ të veçantë i cili do të pranojë ankesat, përgjigje të ankesave dhe do të vendosë sipas bindjes së vet nëse ka bazë për fillimin e procedurës. Procedura disiplinore e filluar duhet të përcaktohet nga një organ i pavarur.

## 2.2.2. Vlerësimi i gjyqtarëve

Llogaridhënia e gjyqtarëve shqyrtohet përmes vlerësimit të tyre të rregullt dhe të jashtëzakonshëm. Gjyqtari vlerësohet sipas rezultateve totale nga suksesi i arritur në punë në përputhje me kriteret cilësore dhe sasore të përcaktuara në Ligjin për gjykatat. Vlerësimi kryhet pa cenuar pavarësinë dhe autonominë e gjyqtarit. Kriteret cilësore vlerësojnë cilësinë e procedurave gjyqësore dhe cilësinë e procedimit të azhurnuar për lëndë gjyqësore.

Cilësia e procedurave gjyqësore përcaktohet përmes këqyrjes në pesë lëndë të zgjedhura rastësisht nga sistemi kompjuterik i automatizuar për menaxhimin e lëndëve gjyqësore dhe pesë raste të përcaktuara nga gjyqtari, ndërsa vlerësohet:

- » aftësia për të argumentuar,
- » gatishmëria për të kryer dëgjimin,
- » përpilimi i procesverbalit dhe dëgjimi i palëve,
- » gatishmëria për të marrë vendime procedurale, dhe
- » aftësia për të zgjidhur konfliktet.

Cilësia e veprimit të azhurnuar të lëndëve gjyqësore vlerësohet përmes depërtimit në të dhënat nga sistemi kompjuterik i automatizuar për menaxhimin e lëndëve gjyqësore dhe shqyrtohet:

- » respektimi i afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve procedurale në procedurë,
- » respektimi i afateve ligjore për miratim, dhe
- » publikimi dhe përgatitja të vendimeve, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore.

128 Raporti i Progresit i vitit 2019 i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

## 2.3 EFEKTIVITETI NË PUNËN E GJYQËSORE

Çfarë është efektiviteti dhe cilat janë kriteret për vlerësimin e efektivitetit të gjyqtarëve?

Ligji për Gjykatat përcakton se qëllimet dhe funksionet e gjyqësorit përfshijnë:

- » “zbatimin e paanshëm të ligjit pa marrë parasysh pozicionin dhe kapacitetin e palëve,
- » mbrojtje, respektim dhe promovim i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore,
- » sigurim i barazisë, mosdiskriminimit mbi çfarëdo baze dhe
- » sigurimin e sigurisë juridike bazuar në shtetin e së drejtës.”<sup>129</sup>

*“GJATË MARRJES SË VENDIMIT PËR TË DREJTAT DHE DETYRIMET CIVILE DHE NË VENDOSJEN PËR PËRGJEGJËSINË PENALE, TË GJITHË KANË TË DREJTË PËR GJYKIM TË DREJTË DHE PUBLIK BRENDA AFATIT KOHOR TË ARSYESHËM PËRPARA NJË GJYKATE TË PAVARUR DHE TË PAANSHME TË THEMELUAR ME LIGJ.”<sup>130</sup>*

*“LËNDËT QË VIJNË NË GJYKATË PËR VENDIM SHPËRNDAHEN NË MËNYRË ELEKTRONIKE MIDIS GJYQËSORE SIPAS KOHËS SË PRANIMIT TË LËNDËS NË GJYKATË, ME PËRJASHTIMIN E ÇDO NDIKIMI NË MËNYRËN E SHPËRNDARJES NGA KRYETARI I GJYKATËS, GJYQTARI OSE ADMINISTRATA E GJYKATËS PËRMES SISTEMIT KOMPJUTERIK TË AUTOMATIZUAR PËR MENAXHIM ME LËNDË GJYQËSORE, NË PËRPUTHJE ME LIGJIN.”*

Efektiviteti nënkupton nëse gjyqtarët arrijnë qëllimet dhe funksionet e pushtetit gjyqësor, si matet ai dhe nëse ekzistojnë parakushte të tjera të nevojshme për të arritur efektivitetin.

129 Teksti i konsoliduar i Ligjit për gjykatat, neni 5.

130 Teksti i konsoliduar i Ligjit për gjykatat, neni 6 (2).



### 2.3.1. Parimet dhe gjykimi në afat kohor të arsyeshëm

Ligji për Gjykatat rregullon parimet mbi të cilat veprojnë gjykatat, shkeljen e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, përsëritjen e procedurës mbi vendimin përfundimtar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve dhe kryetarët e gjykatave, dhe shpërndarjen automatike të lëndëve.

Në procedurat gjyqësore, gjyqtarët zbatojnë parimet e ligjshmërisë dhe legjitimitetit, barazisë së palëve, gjykimin në afat kohor të arsyeshëm, drejtësi, publicitet dhe transparencë, procedurat kundërshtuese, procedurat në dy nivele, elokuencën,

drejtpërdrejtësinë, të drejtën për mbrojtje, përkatësisht përfaqësimi, vlerësimi i lirë i provave dhe ekonomizim.

Garantohet mbrojtja e së drejtës për gjykim në afat kohor të arsyeshëm. Pala që konsideron se gjykata kompetente ka shkelur të drejtën për gjykim në afat kohor të arsyeshëm, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për mbrojtje të së drejtës për gjykim në afat kohor të arsyeshëm në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.<sup>131</sup> Kjo kërkesë mund të paraqitet nga pala gjatë procedurave para gjykatave vendore dhe jo më vonë se gjashtë muaj nga dita e vendimit të plotfuqishëm.

### 2.3.2. Teknologjia informatike

Teknologjia informatike ofron mundësi për përpunim më efikas, më të qartë dhe më të sigurt të lëndëve, veçanërisht në menaxhimin e skedarëve, si dhe në regjistrimin dhe kontrollimin e lëndëve. Kjo mundëson që të krijohen modele specifike për të lehtësuar formulimin e vendimeve gjyqësore ose urdhrave dhe të sigurohet statistika me shumë kritere për secilin lloj të lëndëve gjyqësore që mund të bëhen të publikisht të disponueshme.<sup>132</sup> Sistemi kompjuterik i automatizuar për menaxhim të lëndëve gjyqësore (AKMIS) rregullohet me Ligjin për gjykatat, Ligji për menaxhim me lëvizjen e lëndëve në gjykata,<sup>133</sup> Rregulloren gjyqësore dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor.

Ligji për Gjykatat përcakton se në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë themelohet Qendër e Teknologjisë Informatike, përgjegjëse për menaxhimin teknik të sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhimin e lëndëve gjyqësore, portalin gjyqësor dhe bazat e të dhënave që rezultojnë nga puna e gjykatave. Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është përgjegjës për funksionimin e sistemit kompjuterik të automatizuar. Mënyra e funksionimit të sistemit informatik në të gjitha gjykatat rregullohet nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me akt nënligjor, me pëlqimin paraprak të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.<sup>134</sup>

131 Teksti i konsoliduar i Ligjit për gjykatat, neni 36.

132 Opinion i CCJE nr. (2011)14 "Drejtesia dhe Teknologjia e Informatike (TI)"

133 Ligji për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykata Gazeta Zyrtare e RM-së nr.42/2020

134 Teksti i konsoliduar i Ligjit për gjykatat, neni 99.

Ligji i parë për menaxhim me lëndëve në gjykata u miratua në vitin 2010<sup>135</sup> dhe rregulloi procedurat për funksionimin e AKMIS në secilën gjykatë veç e veç. Në pajtim me ligjin, kryetari i gjykatës ndërmori veprime të përditshme dhe të drejtpërdrejta në lidhje me monitorimin e situatës së përgjithshme me menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykatë. Veprimet kanë të bëjnë me monitorimin e evidencës dhe rishikimet e detyrave të kryetarëve të njësive të gjykatave, gjyqtarëve, administratorit të gjykatës, nëpunësve gjyqësor përgjegjës dhe secilit nëpunës gjyqësor në lidhje me përmbushjen në kohë të detyrave të tyre për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykata. Kryetari i secilës gjykatë gjithashtu ka detyrimin të krijojë një trup punues për të menaxhuar lëvizjen e lëndëve në gjykatë. Ligji i ri i miratuar në vitin 2020, rregullon në mënyrë më të detajuar dhe taksative detyrimet e kryetarit të gjykatës dhe trupit punues, si dhe rregulloret që duhet të miratohen.

Trupi punues i kryesuar nga administratori gjyqësor ose një person i emëruar nga kryetari i gjykatës në gjykatat ku nuk ka administrator gjykatë është kompetent për të përgatitur: projekt plan vjetor për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykatë dhe parandalimin e ngecjes së lëndëve të pazgjidhura ose zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe parandalimin e ngecjes së lëvizjes së lëndëve në gjykatë me: analiza për arsytet për ngecjen e lëvizjes së lëndëve dhe masat e propozuara për tejkalimin e situatës, propozimin e procedurave të brendshme për proceset në menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykatë bazuar në veprimet procedurale dhe afatet e përcaktuara në Ligjin për procedurën civile, Ligjin për procedurën penale, Ligjin për kontestet administrative, Ligjin për procedurën jashtë kontestimore dhe Rregulloren e gjykatës, dhe të paraqesë raport mujor te Kryetari i Gjykatës për zbatimin e planit vjetor për menaxhimin e lëndëve në gjykatë, masat për parandalimin e krijimit dhe zvogëlimit të lëndëve të ngecura dhe të pazgjidhura dhe ngecjen e lëvizjes së lëndëve në gjykatë.<sup>136</sup>

Sipas Rregullores së gjykatës, shpërndarja automatike e lëndëve siguron që secili gjyqtar në gjykatë të marrë numër të barabartë të lëndëve sipas kriterëve të përcaktuara nga Trupi Punues për Standardizim në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kriteret shtesë të përdorura në caktimin automatik të lëndëve përcaktohen nga Trupi Punues i Standardizimit. Kryetari i secilës gjykatë përcakton cilat kriterë në sistemin kompjuterik të automatizuar të menaxhimit të lëndëve gjyqësore do të përdoret në shpërndarjen automatike të lëndëve në secilën njësi dhe është përgjegjës për shpërndarjen e numrit të barabartë të lëndëve te gjyqtarët. Kryetari i gjykatës në orarin vjetor të punës për secilën njësi emëron një nëpunës gjyqësor nga regjistri i gjykatës i cili do të jetë përgjegjës për shpërndarjen automatike dhe rishpërndarjen e lëndëve te gjyqtarët.<sup>137</sup> Me Rregulloren e gjykatës rregullohet shpërndarjen e lëndëve të sapoformuara, dorëzimin e lëndëve dhe punën me shkresat për punën e gjyqtarit dhe rishpërndarjen automatike të lëndëve.

135 Ligji për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykata Gazeta Zyrtare e RM-së nr.171/2010.

136 Ligji për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykata Gazeta Zyrtare e RM-së nr.171/2010, neni 8

137 Rregullorja e gjykatave Shpërndarja automatike e lëndëve, neni 174

Sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor, në Këshill është krijuar Qendra për Teknologji Informatike Komunikimi, Analitikë dhe Statistikë (TIK). Përveç kompetencave të tjera, kjo qendër është përgjegjëse për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të kopjuara për Sistemin Informatik të Gjyqësor i cili ndodhet në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qendra e TIK-ut koordinon aktivitetet e qendrave të tjera të TI-së, në gjyqësor në mënyrë që të përmirësojë zgjidhjet softuerike dhe harduerike.<sup>138</sup>

Funksionimi i plotë dhe i duhur i AKMIS kërkon kontroll të rregullt dhe me kohë mbi punën e AKMIS-it, nga autoritetet kompetente si Këshilli Gjyqësor, Gjykata Supreme dhe Ministria e Drejtësisë; masa në kohë për parandalimin e abuzimit të sistemit nga kryetarët e gjykatave; inicimi i procedurave të përgjegjësive ndaj subjekteve të përfshira në abuzimin e sistemit; optimizimi i AKMIS-it, dhe përshtatja me nevojat e gjykatave; trajnimi i punonjësve në qendrën TIK; ndërveprimi me organet e tjera për qasje më të lehtë në të dhëna dhe shërbime të ndryshme; dhe staf i mjaftueshëm profesional (gjyqtarë, bashkëpunëtorë profesionalë dhe administratorë gjyqësorë).<sup>139</sup>

### 2.3.3. Azhurnimi i gjykatave

Këshilli Gjyqësor në raportet e tij vjetore ofron një pasqyrë të detajuar të numrit të lëndëve të zgjidhura për gjykata dhe kolektivisht në nivelin kombëtar. Raporti Vjetor mbi Punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2020, arrin në përfundimin se gjykatat në vitin 2020 nuk arritën të kapërcejnë fluksin e lëndëve dhe rritën numrin e lëndëve të pazgjidhura për 2.503 lëndë. Njëkohësisht, nga 34 gjykata, 15 gjykata konsiderohen si të përditësuara, ndërsa 19 gjykata konsiderohen të pa përditësuara, 2 nga gjykatat e apelit dhe 17 gjykata themelore. Është konkluduar se kjo situatë është kryesisht për shkak të pandemisë me virusin Covid-19 në vendin tonë.

Duhet të theksohet se në vitin 2019, Këshilli në bashkëpunim me kryetarët e gjykatave morën masa konkrete për të zvogëluar lëndët e vjetra në gjyqësor, më të vjetra se tre, shtatë dhe dhjetë vjet. Në mënyrë që të zvogëlohet numri i lëndëve të vjetra nga 7 dhe 10 vjet, me vendim të Këshillit përmes kryetarëve të gjykatave, gjyqtarët që veprojnë për lidhje me këtë lloj lëndësh, janë të detyruar të përgatisin plan dhe projeksion për zgjidhjen e secilës lëndë.<sup>140</sup> Kjo kontribuon në zgjidhjen e lëndëve të vjetra, si më poshtë:

- » Në vitin 2019: 59,81% e rasteve më të vjetra se 3 vjet; 46,03% të rasteve më të vjetra se 3 vjet dhe 25,16% të rasteve më të vjetra se 10 vjet.
- » Në vitin 2020: 48,56% të rasteve më të vjetra se 3 vjet; 28,3% të rasteve më të vjetra se 3 vjet; dhe 19,46% të rasteve më të vjetra se 10 vjet.

138 Neni 103 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV, Gazeta Zyrtare e RMV nr.102/2019

139 Instituti për të Drejtat e Njeriut, Keqpërdorimi i Sistemit të Automatizuar Kompjuteri i Menaxhimit të Lëndëve (ACMIS).

140 Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019.

Lidhur me azhurnimin e gjyqësorit, duhet theksuar numri i vendeve vakante në gjykata, përkatësisht që në vitin 2020 ka një mesatare prej 8 gjyqtarësh më pak në krahasim me vitin 2019.

### **2.3.4. Efektiviteti i gjyqësorit në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme nga KOVID-19**

Situata me KOVID-19 në vitin 2020 gjithashtu kishte një ndikim mbi azhurnimin e gjykatave. Kjo është konstatuar në Raportin Vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 dhe në Raportin për vitin 2020 të Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me qëllim të luftimit të pandemisë KOVID-19, Qeveria lëshoi një urdhëresë duke pezulluar të gjitha afatet për fillimin dhe vazhdimin e lëndëve penale, civile dhe jashtë kontestimore, kontesteve administrative, kundërvajtjet dhe propozimet për ekzekutimin ose sigurimin e detyrimeve deri në fund të gjendjes së jashtëzakonshme, me përjashtim të lëndëve që janë afër arritjes së vjetërsimit. Gjykatat zbatuan gjithashtu masa parandaluese shëndetësore dhe disa seanca u mbajtën me përdorim të internetit. Duke ndjekur urdhëresën dhe udhëzimet e Këshillit Gjyqësor, shumica e gjykatave kanë miratuar akte të brendshme që rregullojnë punën e tyre, por mungon rregullativë e qartë dhe e saktë, siç konkludohet në Raportin e Komisionit Evropian. Këshilli Gjyqësor konkludon se pavarësisht nga masat e marra për të zvogëluar lëndët e prapambetura, disa nga gjykatat vlerësohen ende si të pa përditësuara.

# 3.

Politikat kombëtare  
dhe korniza juridike  
e transparencës,  
llogaridhënies  
dhe efektivitetit  
të gjyqësorit,  
me fokus në punën  
e administratës  
gjyqësore

---

### 3.1. HYRJE

Transparenca, llogaridhënia dhe efektiviteti janë një nga parimet themelore në funksionimin e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe për shkak të rëndësisë së tyre identifikohen prioritetet ndër strategjike në Strategjinë për Reformën në Sektorin e Jurisprudencës për periudhën 2017-2022.<sup>141</sup> Këto prioritate për sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit në gjyqësor janë të pamundura të arrihen plotësisht pa krijimin e një administrate gjyqësore transparente, llogaridhëse dhe efektive, e cila nga ana tjetër është një faktor jashtëzakonisht i rëndësishëm për të siguruar funksionimin efikas të gjykatave. Fatkeqësisht, Strategjia për Reformën e Sektorit Gjyqësor nuk i kushton vëmendje të veçantë administratës gjyqësore, kështu që përveç detyrimit për të harmonizuar Ligjin për shërbimin gjyqësor,<sup>142</sup> me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik<sup>143</sup>, dhe Ligji për nëpunësit administrativ,<sup>144</sup> nuk ka masa të tjera të qarta në lidhje me administratën gjyqësore.

Në Strategjinë për Reformë në Administratë 2018 - 2022,<sup>145</sup> disa masa dhe aktivitete për transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e punonjësve janë paraparë me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligjin për nëpunësit administrativ. Sipas klasifikimit të bërë sipas Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligjit për nëpunësit administrativ, nëpunësit e gjykatave përfshihen si një lloj i veçantë i nëpunësve administrativë. Sidoqoftë, analiza e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë për Reformën e Administratës 2018-2022 përqendrohet ekskluzivisht në administrimin në organet administrative, që do të thotë se administrata gjyqësore e punësuar në një organ shtetëror është plotësisht e përjashtuar.

Së këndejmi mund të konkludohet se edhe përkundër faktit se ekzistojnë dy dokumente kryesore strategjike në vend që ndikojnë drejtpërdrejt në administratën gjyqësore, asnjë prej tyre nuk përmban pothuajse asnjë masë dhe aktivitete që do të kishin ndikim mbi avancimin e gjendjes dhe statusit të administratës gjyqësore, si në përgjithësi ashtu edhe në aspektin e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit.

Ky konstatim në nivel kombëtar reflektohet si në nivelin rajonal ashtu edhe në nivelin e Bashkimit Evropian. Ekzistojnë organizata rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare që synojnë të mbështesin proceset e administratës publike dhe reformën në drejtësi, por edhe ato nuk parashikojnë drejtpërdrejt ndonjë aktivitet specifik, masa dhe standarde për administratën gjyqësore.

141 Strategjia për reformën e sektorit gjyqësor për periudhën 2017-2022, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë, 2017. Në dispozicion në [https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategjia%20i%20akciski%20plan\\_MK-web.pdf](https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategjia%20i%20akciski%20plan_MK-web.pdf)

142 Ligji për shërbimin gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.43/2014)

143 Ligji për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.27/2014 ..... 14/2020)

144 Ligji për nëpunësit administrativë ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.27/2014 ..... 14/2020)

145 Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2018-2022, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, 2018. Në dispozicion në [https://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl\\_files/documents/strategies/srja\\_2018-2022\\_20022018\\_mk.pdf](https://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/srja_2018-2022_20022018_mk.pdf)

Në fund të kësaj përmbledhjeje të shkurtër të dokumenteve strategjike në lidhje me transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e administratës gjyqësore, duhet të merret parasysh Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2020,<sup>146</sup> i cili thotë se "zbatimi i plotë i parimeve të pavarësisë dhe transparencës duhet të vazhdojë, veçanërisht për t'i dhënë fund të gjitha kritikave për sistemin gjyqësor i cili i nënshtrohet pushtetit ekzekutiv, duke përfshirë sigurimin e emërimeve të bazohen plotësisht në merita dhe kompetencë". Por kjo pjesë vlen më shumë për gjyqtarët sesa për nëpunësit e gjykatave.

### 3.1.1. Efektiviteti në punën e administratës gjyqësore

=Përkundër mungesës së një kornize strategjike të qartë dhe të saktë të qëllimeve, prioriteteve, masave dhe aktiviteteve për forcimin e efektivitetit të administratës gjyqësore, si një nga elementët e rëndësishëm të sektorit gjyqësor, megjithatë, ekzistojnë disa ligje, por edhe aktet nënligjore që mbulojnë këto çështje dhe përmes të cilave mund të analizohet statusi i administratës gjyqësore në lidhje me këto parime. Në të njëjtën kohë, shumë prej akteve të rëndësishme ligjore në vend nuk mbulojnë punën e administratës gjyqësore. Në vazhdim shqyrtohen një numër i ligjeve dhe akteve ligjore dhe fushëveprimi i tyre në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien e administratës gjyqësore.

#### •• *KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT*

Kushtetuta<sup>147</sup> rregullon gjyqësorin, si një degë krejtësisht e veçantë dhe e pavarur e pushtetit, por nuk përmend fare nëpunësit gjyqësorë përkatësisht nuk mund të identifikojmë në të asnjë dispozitë ligjore në lidhje me transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e administratës gjyqësore.

#### •• *LIGJI PËR TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN PUBLIK*

Ligji për të punësuarit në sektorin publik rregullon parimet e përgjithshme, klasifikimin e vendeve të punës, regjistrat, llojet e punësimit, të drejtat e përgjithshme, detyrat dhe përgjegjësitë, lëvizshmërinë, si dhe çështje të tjera të përgjithshme për të punësuarit në sektorin publik. Sipas klasifikimit të bërë në këtë ligj, nëpunësit e gjykatave, si një lloj i veçantë i nëpunësve administrativë, janë të punësuar në sektorin publik. Prandaj për nëpunësit gjyqësor, si dhe për të gjithë punonjësit e tjerë të sektorit publik, vlejné:

146 Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për 2020, Komisioni Evropian, 2020 Në dispozicion në <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657#>. YIGRSORpbU

147 nenet 98-105, Kushtetuta e RMV, miratuar më 17 nëntor 1991 dhe botuar në «Gazeta Zyrtare e RM "numri 52 data 22.11.1991

- » Parimi i transparencës dhe konfidencialitetit - Punonjësit në sektorin publik (përfshirë nëpunësit e gjykatave) gjatë kryerjes së detyrave dhe obligimeve të tyre janë të detyruar të sigurojnë qasje në informacionin publik në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me ligj.
- » Parimi i përgjegjësisë - Punonjësit e sektorit publik (përfshirë nëpunësit e gjykatave) janë përgjegjës ndaj institucionit në të cilin janë të punësuar për pasojat e veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të tyre, përkatësisht mos-vendimet, si dhe për cilësinë, realizimin në kohë dhe me efikasitet të kompetencave të besuara.

## •• **LIGJI PËR SHËRBIMIN GJYQËSOR**

Ligji për shërbimin gjyqësor është akti themelor normativ, i cili rregullon si lex specialis të drejtat, detyrat, përgjegjësitë e nëpunësve gjyqësorë, sistemin e pagave dhe shpërblimeve të nëpunësve gjyqësorë, të cilët janë nëpunës gjykatash që kanë statusin e nëpunësve administrativë. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë çështjet e statusit të nëpunësve gjyqësorë, përkatësisht i njëjti nuk rregullon punën e administratës gjyqësore, kështu që nuk ka dispozita që i referohen dhe rregullojnë transparencën në punën e të njëjtit.

Megjithatë, ligji parashikon procedura transparente për **punësimin e nëpunësve gjyqësorë**, përkatësisht publikimin e detyrueshëm të shpalljes publike për punësimin e nëpunësve të gjykatave në ueb faqen e gjykatës, si dhe në të paktën dy gazeta ditore, nga të cilat njëra nga gazetatat e botuara në gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. Procesverbalet nga të gjitha fazat e procedurës për zgjedhjen e nëpunësve të gjykatës (përzgjedhja administrative, provimi profesional për nëpunësin e gjykatës dhe intervista), së bashku me rang listën, si dhe vendimi për zgjedhjen e kandidatit të renditur më mirë, duhet të publikohen në ueb faqen e gjykatës e cila zhvillon procedurën e punësimit.

Ligji për shërbimin gjyqësor përshkruan gjithashtu transparencën **procedura e avancimit**, me shpalljen e konkursit të brendshëm, procesverbalet nga të gjitha fazat e përzgjedhjes dhe listat e renditjes, si dhe vendimin për avancim në ueb faqen e gjykatës e cila zhvillon procedurën e avancimit.

Në lidhje me **përgjegjësinë e nëpunësve gjyqësor**, Ligji për shërbimin gjyqësor përmban një kapitull të tërë në të cilin është përshkruar në detaje **përgjegjësia disiplinore dhe materiale** nëpunësve të gjykatës. Gjegjësisht, nëpunësi i gjykatës është personalisht përgjegjës për kryerjen e punës dhe detyrave të punës nga vendi i punës. Për shkelje të detyrës zyrtare, nëpunësi i gjykatës, **përgjigjet në mënyrë disiplinore**. Ajo që është e rëndësishme të theksohet është se sipas ligjit, çdo nëpunës gjyqësor dhe person tjetër, në përputhje me ligjin, ka të drejtë të fillojë procedurë disiplinore kundër një nëpunësi gjyqësor, e cila duhet të arsyetohet. Kjo do të thotë që edhe palët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm mund të fillojnë procedurë për përgjegjësi disiplinore kundër nëpunësve gjyqësorë.



Me vendim për konstatimin e shkeljes së lehtë disiplinore, nëpunësit të gjykatës mund t'i shqiptohet një nga masat disiplinore të mëposhtme:

- » paralajmërim me shkrim dhe
- » dënim me para në lartësi prej 20% të lartësisë së shumës një mujore të pagës neto të paguar në muajin e fundit, para shkeljes së vogël disiplinore, që zgjat nga një deri në tre muaj.

Me vendim për konstatimin e shkeljes së rëndë disiplinore, nëpunësit të gjykatës mund t'i shqiptohet një nga masat disiplinore të mëposhtme:

- » dënim me para në lartësi prej 30% të lartësisë së shumës një mujore të pagës neto të paguar në muajin e fundit para shkeljes së rëndë disiplinore që zgjat nga një deri në gjashtë muaj,
- » zhvendosje në vend pune në nivelin më të ulët, përkatësisht titull dhe
- » ndërprerje e marrëdhënies së punës kur kanë ndodhur pasojat e dëmshme për gjykatën dhe gjatë kësaj nuk janë përcaktuar rrethana lehtësuese për nëpunësin e gjykatës që ka kryer shkeljen.

Përveç përgjegjësisë disiplinore, nëpunësit gjyqësorë gjithashtu përgjigjen materialisht nëse, në punë ose në lidhje me punën, me dashje ose nga pakujdesia do t'i shkaktojnë dëm gjykatës.

Në të gjitha këto procedura kundër akteve të Kryetarit të Gjykatës dhe Administratorit Gjyqësor, sigurohen dy nivele të procedurës përmes parashtresave dhe ankesave në Këshillin për Shërbimin Gjyqësor.

Në lidhje me **efektivitetin në punën** e Shërbimit Gjyqësor, Ligji për shërbimin gjyqësor gjithashtu përmban një kapitull të veçantë që rregullon menaxhimin e efektit të zyrtarëve gjyqësorë. Gjegjësisht, gjykatat parashikojnë krijimin e një sistemi për menaxhimin e efektit të nëpunësve të gjykatave, i cili konsiston në përcaktimin e qëllimeve dhe detyrave të punës, përcaktimin e planit individual për zhvillimin profesional, si dhe një procedurë për vlerësimin e efektit të nëpunësit të gjykatës.

Qëllimet e punës dhe detyrat e nëpunësit të gjykatës përcaktohen në bazë të programit vjetor të punës së gjykatave. Qëllimet e punës dhe detyrat e nëpunësit të gjykatës duhet të jenë të qarta, precize, të matshme dhe me një afat kohor të caktuar për realizim. Qëllimet dhe detyrat e punës përcaktohen nga nëpunësi gjyqësor epror i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësin e gjykatës në fund të procedurës së vlerësimit të arritjeve, në dhjetor të vitit aktual për vitin pasardhës.

Nëpunësi gjyqësor udhëheqës, është i detyruar të monitorojë vazhdimisht efektin e nëpunësve të gjykatës për të cilët ai është përgjegjës gjatë gjithë vitit dhe, nëse është e nevojshme, të propozojë masa për përmirësimin e tij. Si pjesë e procesit të monitorimit të vazhdueshëm të efektit të nëpunësit gjyqësor, jo më vonë se 31 maj të vitit aktual, zhvillohet intervistë gjysmë-vjetore. Nëse në raportin për intervistën gjashtëmujore,

nëpunësi gjyqësor epror në bazë të provave, përcakton se nëpunësi gjyqësor nuk i ka përmbushur qëllimet e përcaktuara, përkatësisht tregon rezultate jo të kënaqshme gjatë periudhës gjysmë vjetore, nuk tregon ekspertizën e nevojshme dhe kompetencë, kryen detyrat e punës jo në kohë, përkatësisht nuk tregon interes për cilësinë e detyrave të punës, do të fillojë procedurë për përmirësimin e efektit. Në procedurën për përmirësimin e efektit, propozohen trajnime shtesë ose udhëzime dhe lëshohet paralajmërim me shkrim në të cilin nëpunësi gjyqësor paralajmërohet për mundësinë të vlerësohet me vlerësim negativ nëse, pavarësisht nga indikacionet dhe masat e propozuara deri në fund të vitit për të cilin bëhet vlerësimi, nuk përmirëson efektin e tij. Nëpunësit gjyqësorë duhet të vlerësohen një herë në vit, jo më vonë se 1 dhjetor i vitit aktual. Nota vjetore e nëpunësit gjyqësor merret në bazë të notës së eprorit, i cili merr pjesë me 65%, si dhe notës mesatare të katër nëpunësve të tjerë gjyqësorë me të cilët nëpunësi gjyqësor bashkëpunon drejtpërdrejt, dy në një nivel më të ulët dhe dy në të njëjtin nivel, si dhe dy vlerësues që nuk janë të punësuar në gjykatë, me të cilët nëpunësi gjyqësor ka bashkëpunim të drejtpërdrejtë, i cili merr pjesë me 35%.

Nëpunësit gjyqësorë për të cilët vlerësimi vjetor është "shquhet veçanërisht" do të shpërblehen me bonus, në shumën e një page të marrë në muajin e fundit të vitit, gjatë së cilit është kryer vlerësimi. Për 5% të nëpunësve gjyqësorë të fundit në listën e renditjes, me notë:

- » punësimi i tyre do të ndërpritet nëse vlerësohen me notën "jo kënaqshëm",
- » paga e tyre do të ulet me 20% për një periudhë prej gjashtë muaj nëse vlerësohen me notën "pjesërisht kënaqshëm" dhe
- » paga e tyre do të ulet me 10% gjatë periudhës gjashtë mujore nëse bëjnë pjesë në 5% të fundit në renditjen dhe nuk vlerësohen me notën "nuk kënaq" ose "pjesërisht kënaq".

Megjithatë, miratimi i Ligjit për shërbimin gjyqësor në vitin 2014 nuk u pasua në mënyrë konsekuente edhe me miratimin e rregulloreve përkatëse për këto procedura si akte nënligjore që duhet të përcaktojnë disa faza të këtyre procedurave. Rregullorja e vlerësimit<sup>148</sup>, Rregullorja për përgjegjësinë disiplinore<sup>149</sup>, Rregullore për vlerësimin e nëpunësve gjyqësorë<sup>150</sup>, Rregullorja për shpallje të brendshme<sup>151</sup>, Rregullorja për përgjegjësinë disiplinore për nëpunësit gjyqësorë<sup>152</sup>, Rregullore për përgjegjësinë materiale për nëpunësit gjyqësorë<sup>153</sup> dhe Rregullorja për përmbajtjen e Planit Vjetor

148 Rregullore për mënyrën e zhvillimit të intervistës gjashtëmujore, formën dhe përmbajtjen e raportit, mënyrën e vlerësimit të nëpunësit të gjykatës, formën dhe përmbajtjen e formularëve të vlerësimit, formën dhe përmbajtjen e raportit me listën e rangimit vjetor të vlerësimeve, si dhe përmbajtja e raporteve dhe mënyra e vlerësimit të nëpunësve gjyqësorë në rrethana të tjera ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.275/2020)

149 Rregullore për mënyrën e zhvillimit të procedurës disiplinore për shkelje të rëndë disiplinore ("Gazeta zyrtare e RMV" nr.275/2020)

150 Rregullore për mënyrën e zhvillimit të intervistës gjashtëmujore, formën dhe përmbajtjen e raportit, mënyrën e vlerësimit të nëpunësit të gjykatës, formën dhe përmbajtjen e formularëve të vlerësimit, formën dhe përmbajtjen e raportit me listën e rangimit vjetor të vlerësimeve, si dhe përmbajtja e raporteve dhe mënyra e vlerësimit të nëpunësve gjyqësorë në rrethana të tjera ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.275/2020)

151 Rregullore për formën dhe përmbajtjen e shpalljes së brendshme, mënyrën e paraqitjes së aplikimit për avancim, mënyrën e kryerjes së përzgjedhjes administrative dhe intervistën, si dhe mënyrën e vlerësimit të tyre dhe numrin maksimal të pikëve nga procedura e përzgjedhjes në varësi të kategorive të vendeve të punës për të cilat është shpallur konkursi i brendshëm ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.275/2020)

152 Rregullore për mënyrën e zhvillimit të procedurës disiplinore për shkelje të rëndë disiplinore ("Gazeta zyrtare e RMV" nr.275/2020)

153 Rregullore për mënyrën e zhvillimit të procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë materiale të punonjësve të gjykatës ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.275/2020)

të Trajnimit për Nëpunësit Gjyqësorë<sup>154</sup> e miratuara nga Ministri i Drejtësisë në nëntor 2020, por janë harmonizuar me procedurat e parashikuara në Ligjin për nëpunësit administrativ dhe Ligjin për të punësuarit në administratën publike në të cilët vetëm në klasifikim përmendet shërbimi gjyqësor si një lloj i veçantë i administratës, dhe së këndejmi në pjesën më të madhe janë të pa harmonizuara me dispozitat e Ligjit për shërbimin gjyqësor, kështu që në disa pjesë ato janë të pazbatueshme.

## •• **KODI I ETIKËS PËR TË PUNËSUARIT NË SHËRBIMIN GJYQËSOR**

Bazuar në Ligjin për shërbimin gjyqësor, Kodi i Etikës së punonjësve të Shërbimit Gjyqësor u miratua përmes Shoqatës së Administratës Gjyqësore. Sipas këtij Kodi,<sup>155</sup> punonjësi në shërbimin gjyqësor në kryerjen e punës dhe detyrave të punës udhëhiqet nga parimet themelore të mëposhtme: profesionalizmi, përgjegjësia, ekspertiza, ndërgjegjshmëria, efikasiteti, efektiviteti, afatet kohore, rregullsia dhe ndershmëria. Kodi përmban vetëm dispozita deklarative, por nuk përmban ndonjë përkufizim të asaj që përbën përgjegjshmëri dhe efektivitet në punën e shërbimit gjyqësor.

## •• **LIGJI PËR GJYKATAT**

Ligji për gjykatat<sup>156</sup> është ligj sistemik që rregullon organizimin dhe funksionimin e gjykatave. Sipas këtij ligji, shërbimi gjyqësor përbëhet nga nëpunës gjyqësorë, persona të punësuar në gjykata që kryejnë punë teknike dhe ndihmëse dhe policia gjyqësore, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë, paga dhe sistemi i kompensimit të të cilëve, si dhe menaxhimi i lëndëve gjyqësore rregullohen me ligj. Shërbimi gjyqësor kryen aktivitetet e përcaktuara me ligj në përputhje me parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, përgjegjësisë, efikasitetit, ekonomisë dhe transparencës. Nëpunësit gjyqësorë, brenda kompetencave të tyre, janë të detyruar t'u sigurojnë qytetarëve realizimin efikas dhe ligjor të lirive, të drejtave dhe interesave të tyre kushtetues në procedurat para gjykatave.

Përveç këtyre çështjeve, ky ligj nuk përmban dispozita shtesë për nëpunësit e gjykatave, përkatësisht gjithçka tjetër i referohet gjykatave dhe mbi të gjitha statusit të gjyqtarëve.

154 Rregullore mbi përmbyajtjen dhe formën e Planit Vjetor të Trajnimit për nëpunësit gjyqësorë ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.275/2020)

155 Kodi i Etikës për Punonjësit e Shërbimit Gjyqësor - 15 shtator 2010

156 Ligji për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.102/2019 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/2019)

## •• RREGULLORJA E GJYKATAVE

Rregullorja e gjykatave<sup>157</sup> u miratua në bazë të nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit për gjykatat në vitin 2013 dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së gjykatave në vitin 2014<sup>158</sup>, nga Ministri i Drejtësisë pas marrjes së mendimit paraprak nga Seanca e Përgjithshme e Gjykatës së Lartë. Me Rregulloren e gjykatës, rregullohet organizimi i brendshëm i gjykatave, mënyra e funksionimit të gjykatave, mbajtja e regjistrave të lëndëve, mbajtja e librave arkivor dhe librave të tjerë ndihmës, dhe libra për evidencë, veprimi me dosjet, formularët, punën në lidhje me ndihmën juridike ndërkombëtare dhe veprimi me ankesat dhe propozimet, thirrja dhe shpërndarja e gjyqtarëve porotë, emërimi i përkthyesve të përhershëm gjyqësorë, interpretë dhe ekspertë, mbajtja e statistikave dhe regjistrave dhe zhvillimi profesional i stafit, rregulla për marrëdhënie me publikun, shenjat speciale në automjetet e gjykatës, sistemi informativ në gjykata, regjistrim audioviziv i seancës gjyqësore, si dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e gjykatave. Funksionimi i brendshëm i gjykatave siguron kryerjen e ligjshme, me kohë dhe efikase të funksionit, si dhe pa ndërprerje, në afat kohor të arsyeshëm dhe realizim ekonomik të të drejtave dhe detyrimeve të palëve.

Kryetari i gjykatës kryen veprimtaritë brenda fushës së administratës gjyqësore, organizon punën, udhëheq dhe administron gjykatën. Kryetari i gjykatës kujdeset për sigurimin e personelit të nevojshëm, kushtet teknike dhe organizative për funksionimin e sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhim me lëndë gjyqësore.

Administratori i gjykatës ndihmon kryetarin e gjykatës në kryerjen e detyrave të administratës gjyqësore, në zbatimin e këtyre rregullave të kësaj Rregullore dhe udhëheq me trupin e themeluar të punës për menaxhim me lëndëve në gjykatë.

Administratori i gjykatës udhëheq shërbimin gjyqësor në gjykatë dhe organizon punën e nëpunësve gjyqësor në gjykatë, përveç policisë gjyqësore.

Në lidhje me transparencën dhe përgjegjësinë, është e rëndësishme që gjykatat të mbledhin, organizojnë dhe paraqesin të dhëna statistikore për punën e tyre në formular të përcaktuar, pyetësor statistikor ose format elektronik të përcaktuar. Të dhënat statistikore, brenda afateve të caktuara, paraqiten nga gjykatat në bazë të të dhënave në dosjen elektronike të lëndëve. Të dhënat statistikore dorëzohen në gjykatat më të larta, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, Ministria e Drejtësisë dhe Enti Shtetëror Statistikor, gjykatat mund të paraqesin raporte të unifikuar mujor, tremujor, gjysmë - vjetor dhe vjetor për punën e gjykatave. Në drejtim të përgjegjësisë së gjykatave është detyrimi që raporti statistikor për punën e gjykatave për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut të krijohet pas fundit të çdo muaji automatikisht nga dosjet elektronike të lëndëve. Këto raporte merren në nivel gjykatë. Të dhënat grupohen sipas lëndëve.

157 Rregullorja e Gjykatës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.66/2013)

158 Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së gjykatës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr.114/2014)

Në përputhje me Ligjin për gjykatat, Raporti vjetor për punën e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratohet në Seancën e Përgjithshme dhe publikohet në uebfaqen e gjykatës.

Raportet vjetore për punën e gjykatave shqyrtohen në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës së Lartë, në të cilën ftohen Kryetarët e Gjykatave të Apelit dhe në disa raste edhe Kryetarët e të gjitha ose disa prej Gjykatave Themelore.

Seanca e përgjithshme, pasi shqyrton raportet për secilën gjykatë, jep vlerësimin e saj në formën e një konkluzioni në lidhje me efikasitetin e gjykatës, cilësinë e punës, angazhimin e gjyqtarëve, gjendjen e burimeve njerëzore, pajisjet teknike dhe kushtet e punës. Vlerësimet dhe konkluzionet e miratuara të Seancës së Përgjithshme publikohen në uebfaqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## ●● **LIGJI PËR BUXHETIN GJYQËSOR**

Ligji për buxhetin Gjyqësor<sup>159</sup> nuk përmban dispozita që i referohen transparencës, përgjegjësisë dhe efektivitetit të administratës gjyqësore, përkatësisht ky ligj rregullon procedurën për përgatitjen, përcaktimin dhe realizimin e buxhetit të gjykatës dhe krijimin dhe funksionimin e Këshillit Gjyqësor Buxhetor. Me buxhetin e gjykatës sigurohet financim i qëndrueshëm, afatgjatë, të ekuilibruar dhe të përshtatshme për gjyqësorin, në mënyrë që të sigurojë pavarësinë dhe autonominë e tij kushtetuese dhe ligjore.

Ky ligj mund të përdoret për të analizuar efektivitetin e administratës gjyqësore për arsye që, rregullimi i pagave dhe kontributeve të pagave të punonjësve të gjykatës, ndikojnë drejtpërdrejt në efektivitetin e tyre gjatë punës. Në periudhën e analizuar mund të konkludohet se ndryshimi i Ligjit për shërbimin gjyqësor, i cili nuk ndodhur që nga viti 2014, përkundër faktit se Strategjia dhe Plani i Veprimit i miratuar parashikon afate, pjesërisht në lidhje me kompensimet e veçanta të pagave që ishin parashikuar më parë për gjyqtarët, dhe ato ishin parashikuar edhe në Ligjin për nëpunësit në prokuroritë publike, administrata gjyqësore këtë e arriti me grevë. Kjo nënkupton ndërprerjen e punës së administratës, funksionimin e gjykatave vetëm në raste urgjente, gjë që ndikon drejtpërdrejt në kryerjen efikase të punëve të administratës gjyqësore, dhe kështu funksionimin joefikas të gjykatave në ushtrimin e drejtësisë dhe sigurimin në kohë dhe në mënyrë efektive mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve.

Përmes këtij ligji duhet të analizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë situata me efektivitetin e administratës gjyqësore në lidhje me plotësimin efikas të vendeve të lira të punës dhe avancimin në detyrë. Gjegjësisht, statusi i papërcaktuar i administratës gjyqësore, në lidhje me Ligjin për nëpunësit administrativ dhe Ligjin për të punësuarit në sektorin publik, përkatësisht vetëm në klasifikimin si nëpunës administrativ të një lloji të veçantë, rezulton me kolizion me dispozitat e Ligjit për shërbimin gjyqësor në lidhje me planet vjetore për

159 Ligji për buxhetin e gjykatës ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.60/03, 37/06, 103/08, 145/10)

punësim. Sipas ligjeve të cituara, Plani vjetor për punësim i të gjitha gjykatave përmes shërbimit të ekspertëve të Këshillit Buxhetor Gjyqësor paraqitet për miratim në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Meqenëse edhe këtu ka kolizion me dispozitat e Ligjit për shërbimin gjyqësor në lidhje me afatet në kuadër të të cilave duhet të paraqitet, procedura është shumë e ngadaltë dhe nuk mund të përmbushë nevojat e gjykatave për plotësimin përkatës dhe urgjent të vendeve të punës të nevojshme dhe vakante. Në vitet e kaluara, vërehet tendencë e vendeve të punës vakante në gjykata, për shkak të arsyeve të ndryshme objektive dhe subjektive dhe për shkak se nuk ndiqet me plotësimin e duhur, rezultojnë një ngarkesë për nëpunësit gjyqësorë me kryerjen e më shumë punëve dhe detyra pune që sigurisht ndikojnë në efektivitetin e punës.

Për shkak të mos-miratimit të Rregullores për shpallje të brendshme të parashikuar në Ligjin për shërbimin gjyqësor nga viti 2014, proceset e avancimit të nëpunësve të gjykatave janë plotësisht të pamundësuar, prej këtu rezultojnë edhe pakënaqësia e cila përsëri sigurisht ndikon në efektivitetin e punës dhe largimin dhe vendet e lira të punës.

Një faktor i rëndësishëm në segmente të caktuara për sa i përket sigurimit të transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit janë administratorët e gjykatave në gjykata, por mangësitë dhe dispozitat e papërcaktuara në Ligjin për shërbimin gjyqësor në lidhje me plotësimin e këtyre vendeve të lira dhe zgjedhjen e Administratorëve të Gjykatave, është arsyeja që në disa gjykata administratorët e gjykatave nuk janë zgjedhur për një kohë të gjatë.

Administratorët e gjykatave përbëjnë Këshillin e shërbimit gjyqësor që vendos në shkallën e dytë për ankesat dhe parashtrirat e paraqitura kundër vendimeve të Administratorit gjyqësor ose Kryetarit të gjykatës për pranimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës, për ankesat dhe parashtrirat e paraqitura kundër vendimeve të Administratorit të Gjykatës ose brenda fushëveprimit të punës së tyre, në procedurat disiplinore, mbi ankesat dhe kundërshtimet për ushtrimin e të drejtave të punës së punonjësve në shërbimin gjyqësor dhe jep pëlqim për aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Në përbërjen e Këshillit të Shërbimit Gjyqësor ka 5-pesë anëtarë me mandat të përhershëm, ndërsa periudhë të gjatë kohore ose aspak nuk janë plotësuar pozicionet e Administratorit të Gjykatës në Gjykatën e Lartë Administrative, Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e Apelit Gostivar si dhe në disa Gjykata Themelore me kompetencë të zgjeruar të cilët me mandat prej 2-vjet punojnë me rotacion si anëtarë të Këshillit të Shërbimit Gjyqësor. Kjo vë në pikëpyetje funksionimin efikas të Këshillit të Shërbimit Gjyqësor, i cili vendos në shkallën e dytë për procedurat për të cilat më parë është konstatuar se janë përkufizuar si transparente në Ligjin për shërbimin gjyqësor, ndërsa përmes së cilës mund të analizohet llogaridhënia dhe efikasiteti i shërbimit gjyqësor.

•• *LIGJI PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT<sup>160</sup>*

Ky ligj rregullon procedurën për zgjedhjen e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mënyrën e ushtrimit të funksioneve të tij, zgjedhjen, përfundimin dhe shkarkimin e gjyqtarit dhe gjyqtarit porotë, procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, përcaktimi i ushtrimit në mënyrë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit gjyqësor, monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarëve, mënyrën e punës dhe vendimmarrjen dhe çështje të tjera në lidhje me punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nga vetë lënda e rregullimit mund të shihet që ky ligj nuk ndikon në punën e nëpunësve gjyqësorë, megjithëse është jashtëzakonisht i rëndësishëm për sistemin gjyqësor.

160 Ligji për Këshillin Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.102/2019)

### 3.2. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË PUNËN E ADMINISTRATËS GJYQËSORE

Për të qenë i hapur dhe transparent në punë, kryetari i gjykatës është i detyruar të caktojë një ditë për pranimin e palëve në gjykatë gjatë javës së punës. Koha e pranimit shpallet në tabelën e buletinit gjyqësor dhe para hyrjes së hapësirës së punës ku pranohen palët. Palët dhe personat e tjerë që, për shkak të largësisë ose arsyeve të tjera të justifikuara, e kanë të vështirë të paraqiten përsëri në gjykatë, mund të pranohen jashtë kohës së përcaktuar për pritjen e palëve. Në sekretarinë e gjykatës jepen njoftimet në bazë të të dhënave të lëndës. Njoftimet janë të kufizuara vetëm në të dhënat themelore në lidhje me lëndën: numri i lëndës, gjyqtari që procedon lëndën, në cilën fazë është procedura për lëndën. Nëpunësi i gjykatës nga sekretaria e gjykatës për të dhëna mund të komunikojë përmes telefonit me nëpunësit e gjykatave nga gjykatat e tjera. Njoftimet mund të jepen gjithashtu përmes telefonit, postës elektronike dhe me shkrim në shpenzim të palës kërkuese. Shpjegimet në lidhje me korrektësinë e veprimeve gjyqësore, vendimet, si dhe rezultatin e mundshëm të epilogut nuk lejohen. Kryetari, gjyqtarët dhe nëpunësit e gjykatave në gjykatë sigurojnë kushtet e nevojshme për publicitetin e punës së gjykatës dhe qasjen e duhur në media, për informacionet dhe procedurat aktuale të zhvilluara në gjykatë, duke marrë parasysh interesat e procedurës, privatësinë dhe sigurinë e pjesëmarrësve. Koha, vendi dhe tema e gjykimit shpallen çdo ditë në një vend të dukshëm para sallës ku po zhvillohet gjyqi dhe në video tabelë për njoftime. Për gjykimet për të cilat ka interes më të madh publik, administrata e gjykatës siguron hapësirë për pritjen e një numri të madh të personave, ndërsa këshilli gjyqësor, me urdhër të kryetarit të gjykatës, zhvillon gjyqin në hapësirë të siguar.

Sigurimi i parimit të transparencës në funksionimin e gjykatave arrihet kryesisht përmes katër segmenteve:

- » Zyrë për Marrëdhënie me Publikun
- » Qasje e lirë në informatat me karakter publik
- » Personi përgjegjës - Zëdhënësi i gjykatës
- » Ueb faqja e gjykatës.



## •• ZYRË PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Në pajtim me Ligjin për menaxhimin e lëvizjen e lëndëve në gjykata<sup>161</sup>, në gjykatat detyrimisht formohet Zyra për Marrëdhënie me Publikun, e cila me kërkesë të një personi të interesuar paraqet kopje anonime nga vendimi i kërkuar i publikuar në ueb faqen e gjykatës, në përputhje me ligjin.

Të dhënat tregojnë se në këto zyra ankesat e qytetarëve janë minimale, dhe në disa gjykata nuk ka aspak mundësi për ankesa nga qytetarët.

## •• LIGJI PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONIN ME KARAKTER PUBLIK

Me këtë ligj rregullohen kushtet, mënyra dhe procedura për ushtrimin e të drejtës për qasje falas në informacionin me karakter publik në dispozicion të autoriteteve shtetërore dhe organeve dhe organizatave të tjera të përcaktuara me ligj, organet e komunave, Qytetin Shkup dhe komunat në Qyteti Shkup. Institucionet dhe shërbimet publike, ndërmarrjet publike, personat juridikë dhe personat fizikë që ushtrojnë kompetenca publike të përcaktuara me ligj dhe aktivitete me interes publik dhe partitë politike në fushën e të hyrave dhe shpenzimeve. Duke pasur parasysh faktin se gjykatat janë organe të pushtetit shtetëror, ky ligj rregullon punën e gjykatave për sa i përket transparencës, përkatësisht mënyrës dhe procedurës për realizimin e së drejtës për qasje falas të informatave me karakter publik. Ligji për Qasjen e lirë të informatave me karakter publik është ligji kryesor që duhet të sigurojë transparencë në punën e të gjitha institucioneve të sektorit publik, përfshirë gjykatat.

Të gjithë personat juridikë dhe fizikë kanë qasje të lirë në informacion. Gjykatat janë të detyruara të caktojnë një ose më shumë nëpunës (nëpunës gjykatash) për të ndërmjetësuar në ushtrimin e së drejtës për qasje falas në informacion. Gjykatat janë të detyruara t'i bëjnë publike të dhënat për nëpunësin gjyqësor përgjegjës për ndërmjetësimin me informatat. Nëpunësi i gjykatës për ndërmjetësimin me informatat të karakterit publik kontakton dhe jep informacionin e nevojshëm dhe ndihmon kërkuuesin e informacionit, për të cilin ai/ajo mban regjistra të veçantë për marrjen e kërkesave për informacion, ruajtjen dhe sigurimin e informacionit. Gjykatat janë të detyruara të mbajnë dhe azhurnojnë rregullisht listën e informatave që disponojnë dhe ta publikojnë atë në një mënyrë të arritshme për publikun (faqja e internetit, bordi i buletinit, etj.).

Gjykatat janë të detyruara që kërkuuesit të sigurojnë hapësira për të parë informacionin e kërkuar, dhe nëpunësit e gjykatës për ndërmjetësimin e informatave janë të detyruar të sigurojnë ndihmë në kërkimin e informatave në përputhje me këtë dhe ligjin tjetër.

161 Ligji për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykata ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.42/2020)

Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik<sup>162</sup> përmban dispozita mbi përgjegjësinë kundërvajtëse për kryetarin e gjykatës dhe sekretarin e gjykatës i cili është i autorizuar të ndërmjetësojë në informacionin publik nëse ata nuk i përmbushin detyrimet e tyre ligjore në lidhje me qasjen e lirë në informatat me karakter publik.

Raporti vjetor për punën e përgatitur nga personat përgjegjës të cilët janë të vendosur të ndërmjetësojnë në ushtrimin e së drejtës për qasje falas në informatat me karakter publik në përputhje me ligjin, publikohet detyrimisht në faqen e gjykatës dhe mund të konkludohet se mbi këtë bazë ekzistojnë shumë më tepër kërkesa të paraqitura krahasuar me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun.

## •• PERSONI PËRGJEGJËS - ZËDHËNËSI I GJYKATËS

Shërbimet e zëdhënësit janë më të reja në gjykata dhe nuk janë të vendosura në të gjitha gjykatat. Funkcionin e "zëdhënësit" e kryejnë edhe vet kryetarët e gjykatave ose gjyqtarët e caktuar prej tyre.

Parimi themelor i publicitetit dhe transparencës së procedurave gjyqësore rregullohet më ngushtë nga Ligjet për procedurat të veçanta (LPP, LPK ...) dhe Rregullorja e Procedurës.

Në mënyrë që të informojë punën e gjykatës publikisht hapur dhe objektivisht përmes mediave, kryetari i gjykatës ose personi përgjegjës për marrëdhëniet me publikun i caktuar nga kryetari i gjykatës siguron informacion në lidhje me punën e gjykatës, përkatësisht, kursin e procedurës sipas lëndës konkrete.

Me kërkesë të kryetarit të gjykatës ose personit përgjegjës për marrëdhëniet me publikun, nëpunësit e autorizuar gjyqësorë, presidenti i këshillit, gjyqtari individual ose këshilli që vepron për lëndën, i paraqesin të dhënat e kërkuara në kohën e duhur. Të dhënat në njoftime duhet të jenë të sakta. Informatat e klasifikuara nuk shpallen dhe mbahen me një shkallë të përshtatshme të fshehtësisë në përputhje me ligjin.

Roli proaktiv i zëdhënësve të gjykatave brenda kornizës ligjore kombëtare që rregullon sjelljen e gjykatave në komunikimin me publikun dhe mediat është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Përmes transparencës dhe informimit të vazhdueshëm të publikut, forcohet besimi i qytetarëve në gjyqësorin të cilët përballen me sfida serioze për të siguruar drejtësi në kohë dhe të drejtë. Në mungesë të një kornize ligjore për sjelljen e zëdhënësve të gjykatave, edukimi sigurohet përmes trajnimit në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë dhe projekte të tjera.

162 Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik («Gazeta Zyrtare e RMV» nr.101/2019)

## •• UEB FAQJA E GJYKATËS

Gjykata është e detyruar të informojë publikun përmes faqes së saj në internet duke publikuar:

- » të dhënat nga kompetencat e saj që i kryen, përkatësisht i përcaktohen me ligj,
- » detajet themelore të kontaktit të gjykatës: emri, adresa, numri i telefonit, numri i faksit, adresa e postës elektronike dhe adresa e faqes së internetit,
- » të dhëna për kryetarin e gjykatës, gjyqtarët dhe administratorin e gjykatës (biografia, detajet e kontaktit, etj.),
- » detajet themelore të kontaktit për nëpunësin e gjykatës për ndërmjetësimin e informacionit, të tilla si: emri dhe mbiemri, adresa e postës elektronike dhe numri i telefonit,
- » detajet themelore të kontaktit të personit të autorizuar për raportim të brendshëm të mbrojtur, siç janë: emri dhe mbiemri, adresa e postës elektronike dhe numri i telefonit,
- » lista e personave të punësuar në gjykatë me pozicion, posta elektronike zyrtare dhe telefoni zyrtar,
- » ligjet në lidhje me kompetencat e gjykatës, në lidhje me regjistrin e rregulloreve të botuar në Gazetën Zyrtare,
- » rregulloret e miratuara nga gjykata në formën e akteve nënligjore brenda juridiksionit të saj: rregullore (rregullore për organizimin e brendshëm, rregullore për sistematizimin e vendeve të punës, rregullore për raportimin e brendshëm të mbrojtur, etj.), urdhra, udhëzime, plane, programe, vendime, gjykime dhe lloje të tjera të akteve për ekzekutimin e ligjeve dhe rregulloreve të tjera, kur autorizohen me ligj për këtë,
- » organogram për organizimin e brendshëm,
- » planet dhe programet vjetore të punës,
- » Buxheti vjetor dhe llogaria përfundimtare,
- » planet vjetore financiare sipas tremujorëve dhe programet e zbatimit të buxhetit,
- » raporti i revizionit,
- » llojet e shërbimeve të ofruara nga mbajtësit e informacionit (informacion mbi dispozicionin fizik të shërbimeve dhe informacionin mbi e-shërbimet, të dhëna mbi bazën ligjore, emrin e shërbimeve, dokumentet dhe të dhënat e nevojshme për të kryer secilin prej shërbimeve, mekanizmat e mbrojtjes ligjore dhe të dhëna të tjera përkatëse),
- » tarifat për tarifat për lëshimin e akteve reale (vërtetime dhe certifikata),
- » mënyrën e paraqitjes së kërkesës për qasje në informata (mënyra e paraqitjes së kërkesës me gojë dhe me shkrim për qasje në informata, si dhe kërkesa e paraqitur në mënyrë elektronike),
- » dokumentacionin e plotë për prokurimet publike,
- » propozimi i programeve, programe, qëndrime, mendime, studime dhe dokumente të tjera të ngjashme në lidhje me aktet me kompetencë të mbajtësit të informacionit, njoftimet për publikun për aktivitete të siguruara nga faqja e tyre e internetit në përputhje me kompetencat ligjore, buletin e informacionit, gazetata zyrtare nëse janë obligative në përputhje me ligjin dhe të tjera,

- » raportet për punë të cilat i paraqesin te organet përgjegjëse për kryerjen e kontrollit dhe mbikëqyrjes,
- » të dhënat statistikore për punën, si dhe informacione të tjera, aktet dhe masat që ndikojnë në jetën dhe punën e qytetarëve dhe që dalin nga kompetenca dhe puna e gjykatës dhe
- » informacione të tjera që dalin nga kompetencat dhe puna e gjykatës.

## SHËNIME PËRFUNDIMTARE

Nga gjetjet korniza ndërkombëtare për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitete të gjyqësorit, rezulton se në nivelin rajonal ka me të vërtetë një numër të madh të instrumenteve ligjore dhe mekanizmave institucionalë, të formësuar kryesisht në kuadër të sistemit të Këshillit të Evropës, përmes të cilit standardet në lidhje me transparencën, llogaridhënie dhe efektivitetin e gjyqësorit vendosen dhe azhurnohen vazhdimisht.

Megjithëse këto janë dokumente jo-detyruese që hyjnë në kategorinë e të ashtuquajturit "drejtësi e butë" ata ende kanë autoritet të madh duke filluar nga kapaciteti i ekspertizës së lartë që i formulon dhe shtjellon ato. Njëkohësisht, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka efekt të caktuar në zbatimin e saj edhe jashtë marrëdhënieve midis palëve specifike në raste të caktuara dhe imponohet si burim i së drejtës në të gjitha sistemet juridike kombëtare.

Së këndejmi, të gjitha pikëpamjet dhe mendimet e KKGJE dhe GJEDNJ duhet të merren seriozisht në konsideratë në formësimin e politikave të brendshme gjyqësore si udhëzime në përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse, por edhe gjatë ndërmarrjes së veprimeve konkrete operacionale në nivel të gjykatave në shtet ose në punën e përditshme të gjyqtarëve dhe anëtarëve të administratës gjyqësore.

Në esencën e tyre është angazhimi për avancimin e efektivitetit të veprimeve dhe vendimeve të gjyqtarëve duke shpërndarë siç duhet barrën e përgjegjësive midis gjyqtarëve dhe administratës së gjykatës, përdorimin e teknologjive të reja, thjeshtimin dhe zvogëlimin e kohëzgjatjes së procedimeve dhe forcimin e transparencës përmes përafrimit të mënyrës së funksionimit të sistemit gjyqësor për publikun e gjerë, por edhe shkëmbimin e informacionit mbi proceset gjyqësore specifike dhe rezultatit të tyre.

Së fundmi, të gjitha përpjekjet për të siguruar efektivitetin, transparencën dhe llogaridhënie të gjyqësorit, siç referohet nga standardet e vendosura ndërkombëtare, duhet të jenë të dukshme edhe në kushte të ballafaqimit me krizë shëndetësore, siç është pandemia Covid-19, kur nga kryetarët e gjykatave, gjyqtarët dhe organet e menaxhimit të gjykatave pritet të vazhdojnë të monitorojnë dhe menaxhojnë lëndët në përputhje me përgjegjësitë e tyre, qoftë edhe në distancë, që do të thotë edhe gjykim të lëndëve me prioritet dhe vendosjen e një plani për zgjidhjen e prolongimit të seancave, alokim më i mirë dhe fleksibël i burimeve,<sup>163</sup> si dhe rishqyrtim të disa aspekteve të funksionimit tradicional të gjykatës.<sup>164</sup>

163 European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), CEPEJ Declaration: Lessons Learnt and Challenges Faced by the Judiciary during and after the Covid-19 Pandemic, Ad hoc virtual CEPEJ plenary meeting, Strasbourg, 10 June 2020, CEPEJ (2020)8rev, Parimi 4

164 Ibid, Parimi 7

Transparenca, përgjegjësia dhe efikasiteti si parime në punën e gjyqtarëve dhe institucioneve që lidhen me punën e gjyqtarëve janë baza për realizimin e të drejtave të njeriut. Kuadri ligjor në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmban bazat për rregullimin e këtyre parimeve, të cilat mund të azhurnohen më tej, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, dhe kështu të sigurojnë mbrojtje adekuatë të të drejtave të njeriut.

Publiciteti në punën e gjyqtarëve garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ligjet procedurale. Transparenca në procedurat gjyqësore është e garantuar dhe përjashtimet përcaktohen saktësisht me ligj. Megjithatë, në mënyrë që të rritet përgjegjësia profesionale dhe publike e gjyqtarëve, nevojiten përmirësime të mëtejshme në fushën e publikimit të aktgjykimeve në internet, incizim të seancave, si dhe zyra plotësisht funksionale dhe transparente për marrëdhënie me publikun në gjykata. Njëkohësisht, informacione shtesë mbi raportet vjetore të Këshillit Gjyqësor në lidhje me esencën e kërkesave për përgjegjësi të gjyqtarëve do të kontribuojnë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së gjyqtarëve.

Megjithëse ka një përmirësim në lidhje me përditësimin e punës së gjykatave, megjithatë ende ka nevojë për të përmirësuar më tej afatet kohore të gjykatave dhe për të kapërcyer fluksin e lëndëve. Mbi azhurnitetin e gjykatave gjithashtu ndikohet edhe fakti se të gjitha pozitat gjyqësore nuk janë plotësuar, domethënë që në vitin 2020 ka mesatarisht 8 gjyqtarë më pak krahasuar me vitin 2019.

AKMIS-si, si një sistem i automatizuar kontribuon në rritjen e efektivitetit të gjyqësorit, por nevojiten masa të mëtejshme për funksionimin e plotë dhe të duhur të AKMIS-it, si dhe kontroll të rregullt dhe në kohë të punës së tij.

Puna e gjykatave dhe gjyqtarëve në kohë pandemie ka treguar mangësitë në funksionimin e sistemit gjyqësor në situata të jashtëzakonshme, si dhe nevojën për të siguruar kushte shtesë legjislative dhe teknike për punën e gjykatave në kohë pandemie.

Duke marrë parasysh të gjithë atë që u tha më lartë në lidhje me situatën aktuale në lidhje me transparencën, përgjegjësinë dhe llogaridhënien e administratës gjyqësore, mund të konkludohet se nuk ka kornizë strategjike të përcaktuar qartë që përfshin administratën e gjykatës, përfshirë çështjet e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit. Çështjet e transparencës dhe llogaridhënies së administratës gjyqësore rregullohen nga disa ligje dhe akte nënligjore, të cilat nuk janë të ndërlidhura, për shkak të të cilave monitorimi i rregulloreve të përgjithshme është shumë kompleks edhe për vetë nëpunësit e gjykatave, për shkak të të cilave zbatimi i tyre konsekuent në praktikë është mjaft i vështirësuar.

Për dallim nga çështja e transparencës dhe llogaridhënies, nuk ka asnjë përkufizim ligjor dhe as mekanizëm të vendosur ligjor për monitorimin e efektivitetit të administratës gjyqësore. Madje edhe procedura për menaxhimin e efektit dhe vlerësimit të nëpunësve gjyqësorë nuk është koherente dhe lidhet me efektivitetin e punës së tyre, prandaj vetë

vlerësimi nuk bazohet në kritere të përshtatshme dhe nuk mund të jetë objektiv, kjo veçanërisht pasi duhet të bëjë të njëjtën duhet ta zbatojnë nëpunës gjyqësor udhëheqës dhe nëpunës të tjerë gjyqësorë të drejtpërdrejtë përgjegjës, cilat vendet në gjykata janë kryesisht vakante. Ligji për shërbimin gjyqësor përmban disa dispozita në lidhje me transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin, por ato nuk janë të sistemuara mirë dhe nuk janë të ndërlydhura. Kodi i etikës është tepër i përgjithshëm dhe deklarativ, kështu që nuk mund të paraqesë bazë solide për punë transparente, të përgjegjshme dhe efektive të administratës gjyqësore. Rregullorja e gjykatës përmban disa dispozita që i referohen kryesisht transparencës në punën e gjykatave, por ka shumë pak ose aspak dispozita mbi përgjegjësinë dhe efektivitetin. Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik është një bazë e fortë për transparencë të plotë në punën e të gjitha organeve shtetërore dhe gjykatave. Megjithatë, nëse krahasojmë detyrimet e gjykatave të përfshira në këtë ligj me ato që janë publikuar në ueb faqet e gjykatave, mund të konkludohet se gjykatat aspak nuk kanë harmonizuar punën e tyre me këtë ligj, gjë që tregon ose njohuri të pamjaftueshme të obligimeve të këtij ligji ose mungesë të kapacitetit të administratës gjyqësore për t'iu përgjigjur detyrimeve të këtij ligji.

## REKOMANDIME

Bazuar në njohuritë e kornizës ndërkombëtare për transparencë, përgjegjësi dhe efektivitet të gjyqësorit mund të formulohen nga rekomandimet e mëposhtme të cilat mund të jenë thelbësore për të kapërcyer mangësitë e identifikuara dhe për të përmirësuar situatën aktuale në nivel kombëtar:

- » Të synohet drejt krijimit të një sistemi për menaxhim më efikas të lëndëve nga secili gjyqtar individual dhe forcimin e rolit të kryetarëve të gjykatave në atë pjesë dhe të zbatohen reforma sistematike që synojnë digjitalizimin e gjykatave, specializimin e gjyqtarëve dhe zvogëlimin e vëllimit të lëndëve në gjykata si rezultat i përdorimit më të shpeshtë të ndërmjetësimit dhe formave të tjera të zgjidhjes alternative të kontesteve.
- » Të monitorohet dhe të zbatohet në mënyrë konsekuente praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në procedurat e Gjykatës Supreme kur vendos për kërkesat për mbrojtjen e së drejtës për gjykim në afta kohor të arsyeshëm, me çka do të shmangen shkeljet e nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së dhe do të rrezikohet GJEDNJ të rishikojë efektivitetin e këtij mjeti juridik, përkatësisht të njëjtin ta shpallë joefektiv.
- » Të qaset ndërtimit të relacioneve më të ngushta midis gjykatave dhe mediave, nga njëra anë, dhe gjykatave dhe publikut më të gjerë, nga ana tjetër, në përputhje me pikëpamjet e shprehura në Opinionin nr.7 (2005) e KKGjE, gjatë çka jo vetëm gjyqtarët por edhe kryetarët e gjykatave do të luajnë një rol më të madh, siç kërkohet nga Opinionin nr. 19 (2016) i KKGjE.
- » Njëkohësisht, të monitorohet dhe të zbatohet në mënyrë konsekuente praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me standardet e publicitetit të procedurave gjyqësore në mënyrë që të shmangen shkeljet në të ardhmen të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, nga ai aspekt.
- » Në pajtim me Opinionin nr.22 (2019) më KKGjE dhe instrumentet e tjera përkatëse të Këshillit të Evropës mund të mendohet për ndërmarrjen e hapave në drejtim të forcimit të efikasitetit dhe efektivitetit të gjyqësorit përmes ndarjes së qartë të detyrave midis gjyqtarëve, asistentëve profesionalë dhe këshilltarëve dhe stafit administrativ në gjykata për të siguruar që gjyqtarët janë të përkushtuar në vendimmarrje dhe përpilimin e vendimeve në lëndë më komplekse, ndërsa anëtarët e administratës profesionale të gjykatës janë të përfshirë në mënyrë aktive në përgatitjen e vendimeve në lëndët përsëritëse dhe rutinore, nën mbikëqyrjen e vetë gjyqtarit, dhe ekzekutimi i detyrave administrative i besohet ekskluzivisht stafit administrativ.
- » Njëkohësisht, të qaset forcimit të kapaciteteve të stafit gjyqësor profesional përmes trajnimit dhe edukimit të tij të vazhdueshëm, monitorimit dhe mentorimit të punës së tij nga gjyqtarët dhe anëtarët më me përvojë të administratës gjyqësore, si dhe të mundësohet avancimi i tij në tituj të duhur dhe më tej përzgjedhja në gjyqtarë, në mënyrë që të sigurohet përdorimi i duhur i burimeve njerëzore në gjyqësor, për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të tij.



Bazuar në njohuritë e kornizës ligjore kombëtare të transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të gjyqësorit, me një fokus në punën e gjyqtarëve mund të formulohen rekomandimet e mëposhtme:

- » Forcimi i transparencës së gjykatave përmes funksionalitetit të zyrave për marrëdhënie me publikun.
- » Të sigurohet publiciteti përmes publikimit të vendimeve gjyqësore në internet me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale.
- » Të sigurohet disponueshmëri e shkaqeve / arsyetimit për zgjedhjen ose ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.
- » Të sigurohet disponueshmërinë e arsyeve për përcaktimin e përgjegjësishë së një gjyqtari ose kryetari të një gjykate në raportet vjetore të punës së Këshillit Gjyqësor.
- » Të sigurohet plotësimi adekuat i vendeve të lira të punës.
- » Të sigurohet kontroll i rregullt të funksionimit të AKMIS-it.
- » Duhet optimizim i AKMIS-it dhe përshtatje me nevojat e gjykatave.
- » Të sigurohen trajnime adekuate për të punësuarit në TIK qendër.
- » Të sigurohet ndërveprim i AKMIS-it me organet e tjera për qasje më të lehtë në të dhëna dhe shërbime të ndryshme.
- » Të sigurohet zbatim i rekomandimeve të OSBE / ODHR për punën e gjykatave në kushte pandemie.

Bazuar në njohuritë e kornizës ligjore kombëtare të transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të gjyqësorit, me një fokus në punën e administratës gjyqësore mund të formulohen rekomandimet e mëposhtme:

- » Të pranohet dhe identifikohet roli i rëndësishëm i nëpunësve gjyqësorë në sistemin gjyqësor, ndërsa me këtë edhe theksimi i nevojës gjatë reformës aktuale të sistemit gjyqësor t'i kushtohet vëmendje e veçantë administratës gjyqësore.
- » Duhet të pranohet një qasje moderne, të rritet efikasiteti, të sigurohen kushte më të mira pune, por edhe motivim financiar për të arritur profesionalizmin e plotë të administratës gjyqësore.
- » Të konfirmohet rëndësia e nëpunësve gjyqësorë me përfshirjen e tyre në kornizën strategjike në lidhje me reformën në gjyqësor, me përcaktimin e qëllimeve dhe aktivitete të qarta strategjike për të përmirësuar statusin e përgjithshëm të administratës gjyqësore, përfshirë në fushën e transparencës, përgjegjësishë dhe efektivitetit.
- » Të rishikohet plotësisht Ligjin për shërbimin gjyqësor dhe në të në mënyrë sistemore të rregullohen të gjitha çështjet në lidhje me statusin e shërbimit gjyqësor, duke përfshirë çështjet e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit, me përjashtim të nëpunësve gjyqësorë nga Ligji për nëpunësit administrativ dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik, si dhe miratimin e akteve nënligjore të përshtatshme.
- » Të harmonizohet puna e gjykatave me Ligjin për qasje të lirë në informatat me karakter publik dhe / ose kapacitetet e administratës gjyqësore që t'i përgjigjen obligimeve nga ky ligj.

## LITERATURA E PËRDORUR

- Consultative Council of European Judges, Magna Carta of Judges (Fundamental Principles), Strasbourg, 17 November 2010, CCJE (2010)3 Final
- Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No 2 (2001) of the Consultative Council of European States (CCJE) for the Attention of the Committee of Ministers of the Council of Europe on the Funding and Management of Courts with Reference to the Efficiency of the Judiciary and to Article 6 of the European Convention on Human Rights, Strasbourg, 23 November 2001, CCJE (2001) OP N°2
- Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No. 6 on Fair trial within a Reasonable Time and Judge's Role in Trials taking into account Alternative Means of Dispute Settlement, as adopted by the CCJE at its 5th meeting (Strasbourg, 22-24 November 2004), CCJE (2004) OP No. 6
- Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No. 7 (2005) of the Consultative Council of European Judges (CCJE) "On Justice and Society", adopted by the CCJE at its 6th meeting (Strasbourg, 23-25 November 2005), CCJE (2005) OP No. 7
- Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No. 11 (2008) of the Consultative Council of European Judges (CCJE) to the attention of the Committee of Ministers of the Council of Europe on the Quality of Judicial Decisions, Strasbourg, 18 December 2008, CCJE(2008)5
- Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No. 17 (2014) on the Evaluation of Judges' Work, the Quality of Justice and Respect for Judicial Independence, Strasbourg, 24 October 2014, CCJE(2014)2
- Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No.19 (2016) of the Consultative Council of European Judges (CCJE) on the Role of Court Presidents, Strasbourg, 10 November 2016, CCJE(2016)2
- Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion No.22 (2019) of the Consultative Council of European Judges (CCJE) on the Role of Judicial Assistants, Strasbourg, 7 November 2019, CCJE (2019)6
- Council of Europe, Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights: Right to a Fair Trial (civil limb), Updated on 31 August 2020, [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_ENG.pdf)
- Council of Europe, Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights: Right to a Fair Trial (criminal limb), Updated on 31 August 2020, [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_criminal\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_criminal_ENG.pdf)

- Council of Europe, Recommendation No. R (86) 12 of the Committee of Ministers to Member States concerning Measures to Prevent and Reduce the Excessive Workload in the Courts (Adopted by the Committee of Ministers on 16 September 1986 at the 399th meeting of the Ministers' Deputies)
- Council of Europe, Recommendation No. R (94) 12 of the Committee of Ministers to Member States on the Independence, Efficiency and Role of Judges (Adopted by the Committee of Ministers on 13 October 1994 at the 518th meeting of the Ministers' Deputies)
- Council of Europe, Recommendation CM/Rec(2010)12, adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on 17 November 2010
- Council of Europe, Working Party on Institutional Reforms (GT-REF.INST), Strasbourg, 9 April 2009, Survey of steering and ad hoc committees: Overview of the survey of six steering and ad hoc committees whose terms of reference expire in 2009 (GT-REF. INST(2009)1-final)
- European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), CEPEJ Declaration: Lessons Learnt and Challenges Faced by the Judiciary during and after the Covid-19 Pandemic, Ad hoc virtual CEPEJ plenary meeting, Strasbourg, 10 June 2020, CEPEJ (2020)8rev
- European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), European Judicial Systems: Efficiency and Quality of Justice CEPEJ STUDIES No. 26, 2018 Edition (2016 Data), <https://rm.coe.int/rapport-avec-couv-18-09-2018-en/16808def9c>
- European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), Revised Saturn Guidelines for Judicial Time Management (3rd revision), as adopted at the 31th plenary meeting of the CEPEJ, Strasbourg, 3 and 4 December 2018
- European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), Working Group on Judicial Time Management (CEPEJ-SATURN), Time Requirements arising from Articles 5 and 6 of the European Convention on Human Rights: Implementation Manual for Criminal Cases, Strasbourg, 15 May 2020, CEPEJ-SATURN(2019)3Rev, <https://www.coe.int/en/web/cepej/cepej-work/saturn-centre-for-judicial-time-management>
- European Union, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Central Bank, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, The EU Justice Scoreboard: A Tool to Promote Effective Justice and Growth, COM/2013/0160 final, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:52013DC0160>

## PRAKTIKA GJYQËSORE E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

- *Abdoella v. the Netherlands*, 25 November 1992, Series A no. 248-A
- *Adži-Spirkoska and Others v. the former Yugoslav Republic of Macedonia*, nos. 38914/05 and 17879/05 [2011] ECHR 1970 (3 November 2011)
- *Assanidze v. Georgia* [GC], no. 71503/01, ECHR 2004-II
- *Axen v. Germany*, 8 December 1983, Series A no. 72
- *Baggetta v. Italy*, 25 June 1987, Series A no. 119
- *Bocellari and Rizza v. Italy*, no. 399/02, 13 November 2007
- *Bock v. Germany*, 29 March 1989, Series A no. 150
- *Boddaert v. Belgium*, 12 October 1992, Series A no. 235-D
- *Boškosi v. the former Yugoslav Republic of Macedonia*, no. 71034/13, 4 June 2020
- *Bottazzi v. Italy* [GC], no. 34884/97, ECHR 1999-V
- *Campbell and Fell v. the United Kingdom*, 28 June 1984, Series A no. 80
- *Comingersoll S.A. v. Portugal* [GC], no. 35382/97, ECHR 2000-IV
- *Delcourt v. Belgium*, 17 January 1970, Series A no. 11
- *Diennet v. France*, 26 September 1995, Series A no. 325-A
- *Dobbertin v. France*, 25 February 1993, Series A no. 256-D
- *Fazliyski v. Bulgaria*, no. 40908/05, 16 April 2013
- *Frydlander v. France* [GC], no. 30979/96, ECHR 2000-VII
- *Guincho v. Portugal*, 10 July 1984, Series A no. 81
- *H. v. France*, 24 October 1989, Series A no. 162-A
- *Hummatov v. Azerbaijan*, nos. 9852/03 and 13413/04, 29 November 2007
- *Kalēja v. Latvia*, no. 22059/08, 5 October 2017
- *Katte Klitsche de la Grange v. Italy*, 27 October 1994, Series A no. 293-B
- *König v. Germany*, 28 June 1978, Series A no. 27
- *Kress v. France* [GC], no. 39594/98, ECHR 2001-VI
- *Krestovskiy v. Russia*, no. 14040/03, 28 October 2010
- *Kudła v. Poland* [GC], no. 30210/96, ECHR 2000-XI
- *Lechner and Hess v. Austria*, 23 April 1987, Series A no. 118
- *Lupeni Greek Catholic Parish and Others v. Romania* [GC], no. 76943/11, 29 November 2016
- *Mamič v. Slovenia* (no. 2), no. 75778/01, ECHR 2006-X (extracts)
- *Martins Moreira v. Portugal*, 26 October 1988, Series A no. 143
- *Milasi v. Italy*, 25 June 1987, Series A no. 119
- *Neumeister v. Austria*, 27 June 1968, Series A no. 8
- *Nicolae Virgiliu Tănase v. Romania* [GC], no. 41720/13, 25 June 2019
- *Nikolova and Vandova v. Bulgaria*, no. 20688/04, 17 December 2013
- *Poiss v. Austria*, 23 April 1987, Series A no. 117
- *Pretto and Others v. Italy*, 8 December 1983, Series A no. 71
- *Raza v. Bulgaria*, no. 31465/08, 11 February 2010
- *Riepan v. Austria*, no. 35115/97, ECHR 2000-XII
- *Ringeisen v. Austria*, 16 July 1971, Series A no. 13
- *Scordino v. Italy* (no. 1) [GC], no. 36813/97, ECHR 2006-V
- *Silva Pontes v. Portugal*, 23 March 1994, Series A no. 286-A
- *Šubinski v. Slovenia*, no. 19611/04, 18 January 2007
- *Sürmeli v. Germany* [GC], no. 75529/01, ECHR 2006-VII
- *Unión Alimentaria Sanders S.A. v. Spain*, 7 July 1989, Series A no. 157
- *V. v. the United Kingdom* [GC], no. 24888/94, ECHR 1999-IX
- *Welke and Białek v. Poland*, no. 15924/05, 1 March 2011
- *Wemhoff v. Germany*, 27 June 1968, Series A no. 7
- *X v. France*, 31 March 1992, § ..., Series A no. 234-C
- *Zimmermann and Steiner v. Switzerland*, 13 July 1983, Series A no. 66





ЦЕНТАР ЗА ПРАВНИ  
ИСТРАЖУВАЊА И АНАЛИЗИ  
CENTER FOR LEGAL RESEARCH AND ANALYSIS